



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 762/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.12.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-33686-08-16-2019, me objekt: “*Blerje materiale mjekësore specifike për Shërbimin e ORL në QSUT/Implanti Koklear*”, me fond limit, vlera e pritshme e kontratave 61.925.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: “Fedos” sh.p.k.
Njësia administrative Nr.2, Rruga “Manol Konomi”, Ndërtesa Nr.14, Hyrja 2, Ap.2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.08.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-33686-08-16-2019, me objekt: “Blerje materiale mjekësore specifike për Shërbimin e ORL në

QSUT/Implanti Koklear”, me fond limit, vlera e pritshme e kontratave 61.925.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 19.09.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--------------------------------|-----------------------------------|
| 1. “Evita” sh.p.k. | 33.350.000 lekë, kualifikuar |
| 2. “Fedos” sh.p.k. | 39.000.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “O.E.S Distrimed” sh.p.k. | 55.350.000 lekë, kualifikuar |
| 4. “Biometric Albania” sh.p.k. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 11.10.2019 operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 17.10.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k. dhe operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

[...]Duke mos qene dakort me vendimin e KVO dhe duke respektuar dhe legjislacionin ne fuqi e konkretisht ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar neni 63 pika 1 dhe pika 1.1 Neni 63, pika 1 e ligjit "Per prokurimin publik" (Te drejtat e personit te interesuar): 1. Cdo person, qe ka ose ka pasur interes ne nje procedure prokurimi dhe kur eshte demtuar ose rrezikohet te demtohet nga nje vendim i autoritetit kontraktor, i marre ne kundërshtim me kete ligj, mund ta kundërshtoje vendimin. Neni 63 pika 1.1 e ligjit "Per prokurimin publik": 1.1 Ankesa kunder vendimeve te autoritetit kontraktor paraqitet, se pari, me shkrim, autoritetit kontraktor ne fjale brenda 7 diteve nga dita e nesërme e punes kur ankimuesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per shkeljen e pretenduar, sipas ketij ligji.

Duke qene se shoqeria jone eshte e interesuar per kete procedure prokurimi, pasi u njohem me vleresimin e tenderit ne date 11.10.2019 nga sistemi elektronik APP ëëë.app.gov.al. ku rezulton se jane shpallur te kualifikuar 3 (tre) operatore ekonomike: Evita sh.p.k, Fedos sh.p.k, O.E.S Distrimed, kemi konstatuar disa problematika te cilat cenojne drejtpersedrejt mundesine e konkurimit te drejte ne kete procedure per arsyet si me poshte vijojne:

Nisur nga fakti qe elementi kryesor i Prokurimit eshte Formulari i Ofertes ekonomike duam te veme ne dukje disa pika qe ngrene dyshime mbi menyren e vlersimit nga ana e Komisionit te vlersimit te ofortave. Ne rastin objekt prokurimi eshte percaktuar Cmimi per njesi per Marreveshjen Kuader eshte: 3,096,250 (tre milion e nentedhete e gjashte mije e dyqind e pesedhete) Leke pa TVSH, kjo vlere nenkupton totalin e cmimeve te perllogaritura me cmim per njesi. Referuar cmimit per njesi dhe formulareve te ofertave te paraqitura nga ana e operatoreve ekonomik Komisioni i vlersimit te ofertave duhet te beje nje vleresim te sakte te ofertave duke

kryer detyren e tij funksionale e cila percaktohet ne Ligji Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik i ndryshuar dhe ne VKM Mr. 914, date 29.12.2014 per "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar neni 58 parashikon qe "Kamisioni eshte pergjegjes vetem per shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave...".

Duke bere nje analize te hollesishme te produktit qe ofertohe nga cdo shoqeri pjesemarrrese ne tender vlen te theksojme se implanti koklear eshte nje pajisje komplekse e cila ben pjese ne nje kategori shume specifike te pajisjeve mjekesore, ate te Pajisjeve Mjekesore te Implantueshme Aktive dhe eshte e shoqeruar dhe nga pjeset perberese te saj. Ligj nr. 92/2014 "Per tatimin mbi vleren e shtuar ne Republiken e Shqiperise" ne nenin 51 germa b) ka percaktuar qe: "Jane furnizime te perjashtuara nga TVSH-ja transaksionet me interes te pergjithshem si me poshte: b) fumizimi i bamave, pajisjeve mjekesore te implantueshme aktive dhe pajisjeve mjekesore te implantueshme.

Udhezim nr. 6, date 30.01.2015 "Per tatimin mbi vleren e shtuar ne Republiken e Shqiperise" ka percaktuar cilat jane aparaturat mjekesore te cilat perjashtohen nga pagimi i TYSH. Ne nenin 38 (faqe 105) te ketij udhezimi percaktohet qe eshte e perjashtuar nga TVSH Implanti Koklear me kod NMK 90214000100. Pra qartesisht dallohet qe pjeset perberese sic eshte Mikrofoni, Magnetet, Telefoni me komandim ne distance etj nuk kane kode doganore nuk jane te perjashtuara nga TVSH. Nga kjo rezulton qe vete implanti koklear eshte produkt i cili eshte i perjashtuar nga pagimi i TVSH dhe konkretisht ndersa paisjet perberese te tij jane produkte per te cilat perlllogaritet dhe vlera e TVSH.

Nga vleresimi i tenderit sipas te cilit jane renditur dhe Operatoret ekonomike te kualifikuar jane paraqitur dhe vlerat e ofertuara. Per subjektin O.E.S Distrimed rezulton se eshte paraqitur cmimi njësi ne vlere 2,767,500 lekë pa Tvsh. Lidhur me cmimin e ofruar nga ky operator ekonomik i kerkojme KSHA te bej verifikime te formularit te ofertes duke u mbeshtetur ne dy pika kryesore te shprehura si me poshte:

Se pari, nese operatori ekonomik O.E.S Distrimed ne formularin e ofertes ka deklaruar vleren e TVSH 0 Leke ndodhemi perpara faktit qe kemi mos deklarim te sakte te vleres se TVSH nga operatori ekonomik O.E.S Distrimed duke sjelle si pasoje mospagimin te taksave ose detyrimeve per perfitimin e sherbimeve ose moskryerja e kerkesave te detyrueshme, sic eshte mos kryerja e pagesave te TVSH qe bien ne kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi. Ashtu sic u citua me lart i vetmi Kod NMK ose HS Code sic njihet nderkombetarisht i perjashtuar nga TVSH eshte 90214000100 qe ne rastin konkret eshte elektroda e cila implantohe ne Koklea (implanti koklear). Komisioni i Shqyrtimit te ankesave me ri-kontrollimin e Formularit te Ofertes ekonomike lehtesisht verifikon nese O.E.S Distrimed ka deklaruar TVSH per pjeset perberese te implantit Koklear apo jo. Nese nuk ka deklaruar TVSH ne formularin e ofertes per pjeset perberese automatiksht jemi ne kushtet e skualifikimit te ketij operatori ekonomik sepse shkelen dispozitat e legjislacionit tatimor, doganor por dhe Rregullave te Prokurimit Publik dhe Shtojces 1 te DST e cila pervec se kerkon nje perskrim te produkteve kerkon vleren Neto dhe TVSH per keto produkte.

Se dyti, nese marrim te mireqene faktin qe operatori ekonomik O.E.S Distrimed ka ofertuar dhe vleren e TVSH i kerkojme KSHA te verifikoje nese vlera e TVSH eshte shprehur dhe ne cmimin total sipas kerkeses se DST, Kriteret e vecanta te kualifikimit- pika a) Ku percaktohet qe Formulari i Ofertes" sipas Shtojces 1 (te plotesohet me te dhenat per sasine e pritshme, cmimin per njesi dhe vleren e pritshme te kontrates per objektin e prokurimit);

-Lidhur me kete dyshim theksojme se Komisioni i shqyrtimit te ankesave duhet te beje nje rivleresim te situates se perlllogaritjes se ofertës se paraqitur nga O.E.S Distrimed;

-Neni 14 i VKM Nr. 914, date 29.12.2014 per "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", "Gjate pergatitjes se ofertave, kandidatet ose ofertuesit duhet te perfshijne te gjitha detyrimet fiskale, qe jane ne fuqi deri ne 28 (njetzet e tete) dite para hapjes se ofertave, me perjashtim te TVSH-se, e cila, nese eshte e aplikueshme, do te llogaritet mbi vleren e ofertës. Bazuar ne ligj operatori ekonomik ne formularin e vleresimit te ofertës duhet te perfshije dhe llogaritjen e TVSH e cila eshte e aplikueshme per pjeset perberese te implantit koklear. Nese operatori ekonomik O.E.S Distrimed nuk ka percaktuar ne formular oferte dhe vleren e TVSH atehere kjo tregon qartesisht qe KVO nuk ka vleresuar sic duhet oferten ekonomike dhe nuk ka marre parasysh qe mungesa e percaktimit te TVSH ne kete formular perben shkak per skualifikim te ketij operatori ekonomik, pasi ky operator ekonomik paraqet nje oferte ekonomike duke mos paguar detyrimet tatimore dhe taksat e vendosura sipas ligjit.

-Operatoret ekonomike duhet te plotesojne ofertat e tyre duke patur parasysh nevojat sasiore dhe fondet limit per cdo autoritet kontraktor, te percaktuara ne tabelen e pergjithshme dhe tabelat e vecanta me te dhenat e paraqitura (ne shtojcen 1) te dokumentave standarte te tenderit. Tejkalmi i fondit per cdo autoritet kontraktor eshte kusht skualifikues.

-Autoriteti kontraktor gjate shqyrtimit te ofertave duhet te jete ne respektim te dispozitave ligjore, perfshire edhe të dispozitave e nenit 53, pika 2 të LPP [...].

-Gjithashtu kerkojme vleresim te ofertës ekonomike sepse nese operatori ekonomik, ka TVSH për produktet qe oferton atehere nepermjet perlllogaritjes mund te rezultojë qe cmimi i ofruar tejkalon limitin per cmim njesi te percaktuar nga DST.

Ne nenin 46, pika 1, te Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: [...].

-Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertës, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme. KVO ka kualifikuar nje operator ekonomik i cili jep nje oferte ekonomike pervec se nese llogaritet vlere e TVSh eshte me e larte se cmimi per njesi, nese paraqitet TVSh 0 leke duke bere qe ky operator te shkele normat ligjore nepermjet shmangies se pagimit te detyrimeve TVSH per sherbimin e marre.

-Sipas nenit 45 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ne kushtet kur nese vleresohet dhe rishikohet formulari i ofertës ekonomike te paraqitur nga ky operator ekonomik dhe rezulton qe dyshimi jone eshte i vertete jemi perpara kushteve te skualifikimit te ketij operatori ekonomik.

Gjithashtu kerkojme nga ana e Komisionit te shqyrtimit te ankesave te bej verifikime te produktit te ofertuar nga ana e operatorit ekonomik Evita sh.p.k ne vlere 1,667,500 leke. Oferta e paraqitur nga ky operator ekonomik krijon dyshime nese operatori ka ofertuar modelin e produktit qe pennbush te gjitha specifikimet teknike te kerkuara. Dyshimet lidhur me plotesimin e kritereve nga ky operator ekonomik lindin per arsytet e meposhtme:

- Per implantin koklear jane vetem 3 prodhues ne te gjithë boten dhe pjeset perberese te paisjes jane praktikisht te njejte ne numer, element ky qe ben te thjeshte krahasimin e vlerave monetare te seciles pjese perberese te produktit.
- Specifikimet teknike te cilat krijohen dyshime nese zbatohen dhe perputhen me kerkesat e DST nga ky operator ekonomik jane Specifikimet teknike te pikave 8, 13, 15, 17 dhe 21.
- Fokusi kryesor vihet ne keto specifikime pasi keto jane specifikime te cilat kane kosto financiare dhe duke pare cmimin e ofruar nga Evita sh.p.k krijohen dyshime nese oferta e paraqitur i perfshin kostot financiare te ketyre specifikimeve apo jo.
- Fillimisht i kerkojme KSHA te verifikojë nese operatori Evita ka ofertuar aksesoret per procesorin e zerit te cilet e bejn rezistent kunder ujit sipas standarteve IP68. Pika 8 - Mundesia per te dhene nje procesor zeri kundra ujit (ëaterproof). Theksojme qe te gjithë procesoret e zerit duhet te vishen me aksesor special per te realizuar mbrojtjen, kunder ujit dhe Modelet baze te procesoreve nuk e kane te perfshire. Kerkojme qe te shikohet nese vlera financiare e ketij aksesori eshte e perfshire ne oferten e operatorit ekonomik.
- Ne te njejten llogjike kerkojme verifikime per piken 13 - Implanti duhet te jete me kellef titaniumi te marresit/stimulatorit. Pasi dhe ne kete rast kemi te bejme me ofertim te verioneve standarte ose te versionit qe perfshin kete aksesor.
- Gjithashtu kerkojme nga KSHA te bej verifikime nese funksionet sipas pikave 15 - Rezonance Magnetike 1.5 deri ne 3 T pa pasur nevojë te hiqet magneti nga trupi i implantit dhe 17 - Identifikim elektronik ndermjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkembimin aksidental te procesorit te zerit nga paciente te ndryshem ose nga ane te ndryshme dhe nese plotesohen dhe nese jane perfshire ne dokumentacionet plotesues te ofertes ekonomike. Ne lidhje me piken 15 i kerkojme KSHA te verifikojne nese Operatori ekonomik Evita sh.p.k ka ofertuar versionin qe suporton Rezonancen 3T qe aktualisht eshte e instaluar prane QSUT. Mos ofertimi i ketij funksioni ka ndikim si nga ana financiare e ofertes ashtu dhe tek pacientet te cileve i mohet e drejta per te perdorur sherbimet spitalore te nje rendesie te vecante sic eshte MRI 3T. Gjithashtu mungesa e funksionit sipas pikes 17 kufizon pacientet qe te jene ne kontakt ose ne afersi me persona te tjere qe perdorin te njejten paisje duke mos i plotesuar te plote sherbimin qe i eshte ofertuar.
- Kerkojme gjithashtu te verifikohet nese OE ka marre deklarate nga prodhuesi qe te mbuloje shpenzimet per plotesimin e pikes, 21 Cdo Implant duhet te jete i shoqeruar me Instrumentet pershtates dhe kirurgjikale i cili duhet te ofrohet falas, 1 set.
- Pra sic u citua me larte te gjitha keto specifikime teknike kane kosto financiare per te cilat i kerkojme KSHA te beje verifikimet nese jane perfshire ne oferten perfundimtare prej 1,667,500 Leke nga OE.
- Ne nenin 53/3 te LPP-se percakohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit..."
- KVO duhet te tregohet konkrete, e drejte dhe te beje verifikimin e duhur nese ky operator ekonomik i ploteson te gjitha kriteret e percaktuara sepse fakti qe cmimi i ofruar eshte i ulet dhe kostoja financiare e disa prej specifikimeve teknike eshte e larte na ve perpara dyshimit qe Operatori ekonomik jep nje cmim te ulet dhe nuk ploteson keto specifikime teknike qe kerkohen ne DST ose Operatori ekonomik ka nje oferte anomalisht te ulet krahasuar me dy operoret e tjere ekonomike. Per Evita sh.p.k duhet te verifikohet qartesisht oferta e tij duke studiuar anen

ekonomike te metodes se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara gjithashtu dhe origjinaliteti i sherbimit te kerkuar pasi pjeset perberese te implantit koklear dhe specifikimet teknike qe kerkohen kane ndikim te drejtperdrejte ne kosto financiare te produktit te ofertuar. Autoriteti kontraktor duhet te mbaje ne vemendje faktin se specifikimet teknike duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 23 te LPP dhe qe i vlereson mallrat si te pranueshme per funksionet e kerkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika l e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Ne legjislacionin e prokurimit publik, eshte percakruar qartesisht se, operatoret ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi duhet te paraqesin dokumentacionin e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor dhe KVO eshte pergjegjese per vleresimin e ketij informacioni dhe kerkimin e informacioneve gjendur perpara dyshimeve te argumentuara dhe te arsyeshme qe operatoret ekonomike O.E.S Distrimed dhe Evita sh.p.k kane shkelje ne procedurat e tyre te prokurimit. Kerkojme qe Autoriteti Kontraktor te marre per baze kerkesat tona per kete procedure te paraqitur me lart, kerkojme pranimin e ankeses tone, ri-verifikimine Ofertes se paraqitur nga Operatori ekonomik O.E.S Distrimed, dhe Evita sh.p.k, skualifikimin e ketyre shoqerive nga kjo procedure prokurimi pasi qendriini i KVO eshte devijim total dhe shkelje e LPP dhe e kerkesave e specifikimeve te kerkuara ne DST.

Duke Ju uruar pune te mbare, brenda afateve te parashikuara ne ligj, mbetemi ne pritje te pergjigjes, si shkalle e pare ankimi.

II.5. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, me shkresën nr. 3570/4 prot., datë 29.10.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka argumentuar se:

[...][...]

Anetaret e Komisionit te Shqyrtimit te Ankeses (KSHA), referuar dhe specializimeve perkatese, argumentojne si me poshte vijon:

Vleresimi dhe gjykimi i KSHA:

Ne zbatim te dispozitave ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar, VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, DST-se, si dhe dispozitave ligjore dhe nenligjore ne fuqi, KSHA konstaton se:

Ankuesi OE "FEDOS" Shpk., ne lidhje me proceduren objekt ankimi, pas shpalljes se renditjes nga AK ne SPE, ka ushtruar te drejten ligjore te ankimit brenda afatit te parashikuar ne nenit 63, pika 2 te LPP. Per sa i perket pretendimeve te OE ankimues, KSHA ne zbatim te parashikimeve te Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar, si dhe VKM 914/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te ndryshuar, gjykon se:

Ne lidhje me pretendimin e pare te OE ankimues si me siper, ku kerkohet skualifikimi i OE OES Distrimed Shpk., oferta e te cilit eshte kualifikuar si e vlefshme dhe eshte renditur e treta:

... [...] ...Se pari, nese operatori ekonomik O.E.S Distrimed ne formularin e ofertes ka deklaruar vleren e TVSH 0 Leke ndodhemi perpara faktit qe kemi mos deklarim te sakte te vleres se TVSH

nga operatori ekonomik O.E.S Distrimed duke sjelle si pasoje mospagimin te taksave ose detyrimeve per perfitimin e sherbimeve ose moskryerja e kerkesave te detyrueshme, sic eshte mos kryerja e pagesave te TVSH qe bien ne kundershtrim me dispozitat ligjore ne fuqi. Ashtu sic u citua me lart i vetmi Kod NMK ose HS Code sic njihet nderkombetarisht i perjashtuar nga TVSH eshte 90214000100 qe ne rastin konkret eshte elektroda e cila implantohet ne Koklea (implanti koklear). Komisioni i Shqyrtimit te ankesave me ri-kontrollimin e Formularit te Ofertes ekonomike lehtesisht verifikon nese O.E.S Distrimed ka deklaruar TVSH per pjeset perberese te implantit Koklear apo jo. Nese nuk ka deklaruar TVSH ne formularin e ofertes per pjeset perberese automatiksht jemi ne kushtet e skualifikimit te ketij operatori ekonomik sepse shkelen dispozitat e legjislacionit tatimor, doganor por dhe Rregullave te Prokurimit Publik dhe Shtojces 1 te DST e cila pervec se kerkon nje pershkrim te produkteve kerkon vleren Neto dhe TVSH per keto produkte.

Se dyti, nese marrim te mireqene faktin qe operatori ekonomik O.E.S Distrimed ka ofertuar dhe vleren e TVSH i kerkojme KSHA te verifikojme nese vlera e TVSH eshte shprehur dhe ne cmimin total sipas kerkeses se DST, Kriteret e vecanta te kualifikimit- pika a) Ku percaktohet qe Formulari i Ofertes" sipas Shtojces 1 (te plotesohet me te dhenat per sasine e pritshme, cmimin per njesi dhe vleren e pritshme te kontrates per objektin e prokurimit); -Lidhur me kete dyshim theksojme se Komisioni i shqyrtimit... [...];

KSHA vlereson se, nga AK, ne DST, eshte kerkuar Implant Koklear ne teresi, duke percaktuar edhe specifikimet teknike qe duhet te plotesoje ky impiant per te cilin do te ofertohej, ne menyre qe oferta e paraqitur nga OE te kualifikohet si oferte e vlefshme. Ne DST nuk ka te percaktuar pjese perberese apo aksesore te Implantit Koklear per te cilet edhe mund te parashikohet TVSH-ja, kjo nisur nga fakti qe Operatore te ndryshem mund te ofertojne nga prodhues te ndryshem dhe Implante te ndryshem mund te kene pjese perberese apo aksesore te ndryshem te cilet nuk mund te parashikohen nga AK ne hartimin e specifikimeve teknike. Per sa i perket deklarimit apo jo te TVSH nga nje operator ekonomik, ky tager ligjor nuk eshte kompetence as e KVO, as e KSHA apo AK ne teresi, pasi AK nepermjet shpalljes/publikimit te DST-ve, dhe me tej nepermjet KVO apo edhe KSHA, ka per detyre funksionale zbatimin me rigorozitet te parashikimeve te LPP dhe RrPP ne menyre qe te plotesoje kerkesat e veta per mallra apo sherbimet etj., dhe me pas te sigurohet qe ofertat ekonomike te paraqitura nga OE te ndryshme te plotesojne kerkesat e bera ne DST nga AK sipas percaktimeve te nenit 53, pika 3, 4, 5/c, dhe nenit 54 te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, te VKM Nr. 914, date 29.12.2014 per "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar. Per kete arsye, KSHA, referuar edhe percaktimeve te nenit 63 te LPP (Te drejtat e personit te interesuar) ku citohet se: 1. Cdo person, qe ka ose ka pasur interes ne nje procedure prokurimi dhe kur eshte demtuar ose rrezikohet te demtohet nga nje vendim i autoritetit kontraktor, I marre ne kundershtrim me kete ligj, mund ta kundershtojte vendimin, vlereson se per pretendimin e pare te ngritur nga OE Fedos shpk., ky OE nuk legjitimohet ne nje kerkim te tille, pasi Neni 63, pika 1 kerkon shprehimisht qe ankimesi, jo vetem te kete interes, por edhe te jete demtuar realisht apo te rrezikohet te demtohet nga vendimi qe ka marre autoriteti kontraktor, dhe ne kete rast OE FEDOS Shpk., as nuk eshte demtuar nga Vendimi i KVO per kualifikimin e OES Distrimed Shpk., dhe as nuk rrezikon te demtohet nga nje vendim i tille, pasi oferta e paraqitur nga OES Distrimed Shpk., renditet e fundit (pas ofertes se Fedos Shpk.,) sipas kriterit te vleresimit te referuar ne DST.

Per kete arsye dhe sa me siper KSHA vlereson se kerkesa e here nga OE Fedos per kete pike nuk qendron.

Ne lidhje me pretendimin e dyte te OE ankimes si me siper, ku citohet qe:

... [...]... Gjithashtu kerkojme nga ana e Komisionit te shqyrtimit te ankesave te bej verifikime te produktit te ofertuar nga ana e operatorit Ekonomik Evita sh.p.k ne vlere 1,667,500 leke. Oferta e paraqitur nga ky operator ekonomik krijon dyshime nese operatori ka ofertuar modelin e produktit qe permbush te gjitha specifikimet teknike te kerkuara. Dyshimet lidhur me plotesimin e kriterëve nga ky operator ekonomik lindin per arsyet e meposhtme: ... [...];

KSHA vlereson se e gjithë gama e ankimit është e ndertuar dhe referohet vetem mbi bazen e informacionit qe OE Ankues "FEDOS" Shpk., pretendon se disponon, si dhe ndertohet mbi dyshime te OE Ankues per menyren e ndertimit te Ofertes se OE Evita Shpk., per te cilen citon se është oferte e dyshimte nese i ploteson specifikimet teknike apo jo, per shkak te ofertes se ulet financiare me te cilen OE Evita ka ofertuar. Oferte e cila ne vleresim te KSHA nuk ka ndonje diference te madhe me oferten e paraqitur nga OE ankues. Per me teper KSHA sqaron se per rastet ne fjale, legjislatori ka parashikuar edhe sigurine juridike nepermjet konstatimit si oferte anomalish e ulet se bashku me hallkat procedurale qe duhet te ezaurohen ne menyre qe oferta te kualifikohet si e vlefshme apo jo, procedure e cila nga konstatimet, rezulton se KVO ka zbatuar percaktimet e nenit 66, pika 5 te Kreut VII te RrPP., ku citohet se: Nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kerkoie sqarime nga ofertuesit, perpara se te marre vendim per kualifikimin ose io te tyre, ne perputhie me nenin 56 te LPP ... [...]; dhe me pas duke u bazuar ne sqarimet e paraqitura ka vleresuar si te vlefshme oferten e paraqitur nga OE Evita Shpk. Me tej KSHA vlereson se OE ankues ne asnje rast, ankimit nuk i bashkelidhet dokumentacion teknik e ligjor qe te vertetoje ato qe ankuesi referon ne lidhje me pretendimet e ngritura per OE Evita Shpk., apo te ndihmoje AK ne thellimin e hetimit administrative per te dhene nje pergjigje bazuar ne parimin stricti iuris, pasi referuar dokumentacionit te vene ne dispozicion nga Njesia e Prokurimit, rezulton se oferta e bere nga OE Evita Shpk., i permbush specifikimet teknike te kerkuara nga AK sipas gjykimit te KVO dhe referuar legjislacionit ne fuqi, qofte ne kete rast, si dhe ne rastin qe OE Fedos Shpk., apo cdo OE tjeter shtron pretendime per nje operator tjeter ekonomik, ne ankesen e paraqitur, ka detyrimin ligjor per te argumentuar pretendimet e ngritura, ne kuptimin klasik te barres se proves (kur barra e proves i bie kerkuesit) dhe ne rastin objekt shqyrtimi, OE FEDOS Shpk., ne asnje rast nuk ka sqaruar, argumentuar dhe me pas provuar me dokumente shtese (por vetem referuar dhe mbi bazen e pretendimeve dhe informacionit qe disponon) faktin e mosplotesimit te specifikimeve teknike nga OE EVITA Shpk. Kete argumentim KSHA e mbeshitet ne dispozitat e Kodit te Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise, neni 12 ku citohet se: "Pala qe pretendon nje te drejte, ka detyrim qe, ne perputhje me ligjin, te provojefaktet mbi te cilet bazon pretendimin e saj", neni 14 (Parimi i Objektivitetit) ku citohet se: Gjate: ushtrimit te veprimtarise administrative, organet publike marrin ne konsiderate dhe i japin rendesine e duhur te gjitha kushteve, te dhenave dhe provave qe lidhen me proceduren administrative", neni 47 (E drejta per te paraqitur mendime dhe shpjegime) ku citohet se: "Te gjitha palet, ne cdo faze te procedures, kane te drejte te paraqesin mendime dhe shpjegime per faktet, rrethana apo ceshtje ligjore, si dhe te depozitojne prova ose te paraqesin propozime per zgjidhjen e ceshtjes", neni 78 (Bashkepunimi gjate hetimit administrativ), pika 1 ku citohet se: "Pala bashkepunon me organin publik ne

percaktimin e fakteve dhe rrethanave te nevojshme per zgjidhjen e ceshtjes. Ligji mund te parashikoj shprehimisht detyrimin e metejshem te pales per te paraqitur informacione, prova, dokumente, deklarata apo per t'u paraqitur personalisht perpara organit publik", si dhe nenit 82 (Barra e proves), pika 1 ku citohet se: "Ne procedurat administrative, te filluara me kerkese te pales qe inicion proceduren, barra e proves per faktet e pretenduara bie mbi kete pale, pavaresisht nga detyrimi i organit publik per te vene ne dispozicion te paleve provat e zoteruara prej saj".

Per kete arsye dhe sa eshte parashtruar me lart, KSHA vlereson se pretendimi i dyte i ngritur nga OE ankues, nuk qendron.

Per sa eshte argumentuar me siper, si dhe ne kuader te frymes se transparences te cilen legjislatori e synon nepermjet legjislacionit te prokurimit publik dhe akteve nenligjore per zbatim te tij, KSHA ne respektim te detyrimeve qe burojne nga dispozitat e ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar si dhe VKM nr. 914/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te ndryshuar, ka arritur ne, Konkluzionin: Te mos pranoje pretendimet e ngritura nga OE "FEDOS" shpk, ne ankesen e administruar prane AK QSU "Nene Tereza" me nr. 3570 prot., date 17.10.2019.

II.6. Në datën 30.10.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Konkretisht, operatori ekonomik ankimues ka argumentuar:

[...]

VI. Sa me siper, konstatohet se operatori ekonomik FEDOS sh.p.k ka ezauruar ankimin administrativ prane autoritetit kontraktor brenda afatit te parashikuar nga neni 63 pika 2 te L.P.P. se. Me marrjen e ankeses ne dorezim nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka detyrimin ligjor te shqyrtoje ankesen dhe te marre nje vendim te arsyetuar brenda 7 diteve pas marrjes se ankeses, te cilin duhet t'ia njoftoje ankuesit jo me vone se ne ditën vijuese te punes.

VII. Operatori ekonomik Fedos duke mos qene dakort me arsyetimin e Autoritetit Kontraktor Ju drejtohet ju si shkalla me e larte e shqyrtimit te ankeses duke u referuar dhe zbatuar ligjin "Per prokurimin publik" i ndryshuar Neni 63, pika 1 dhe 6 6 i cili percakton.

Neni 63, pika 1 e ligjit "Per prokurimin publik" (Te drejtat e personit te interesuar): 1. Cdo person, qe ka ose ka pasur interes ne nje procedure prokurimi dhe kur eshte demtuar ose rrezikohet te demtohet nga nje vendim i autoritetit kontraktor, i marre ne kundersiztim me kete ligj, mund ta kundersiztoj vendimin. Neni 63 pika 6 e ligjit "Per prokurimin publik": 6. Nese autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesen brenda afatit kohor te percaktuar ne piken 5 te ketij neni, ose e refuzon ate, ankimuesi mund te paraqese nje ankese me shkrim ne Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 diteve nga dita e neserme e punes, pas perfundimit te afatit kohor, te percaktuar ne piken 5 te ketii neni, ose, ne rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, qe nga dita kur ankuesi eshte njoftuar nga autoriteti kontraktor. Nje kopje me shkrim e ankeses i dergohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.", ju drejtohem ju si shkalla me e larte per shqyrtimin e ankeses tone.

Se pari lidhur me arsyetimin se: "Ne DST nuk ka te percaktuar pjese perberese apo aksesore te Implantit Koklear per te cilet edhe mund te parashikohet TVSH-ja, kjo nisur nga fakti qe Operatore te ndryshem mund te ofertojne nga prodhues te ndryshem dhe Implante te ndryshem mund te kene pjese perberese apo aksesore te ndryshem te cilet nuk mund te parashikohen nga

AK ne hartimin e specifikimeve teknike. Per sa i perket deklarimit apo jo te TVSH nga nje operator ekonomik, ky tager ligjor nuk eshte kompetence as e KVO, as e KSHA apo AK ne teresi, pasi AK nepermjet shpalljes/publikimit te DST-ve, dhe me tej nepermjet KVO apo edhe KSHA, ka per de tyre funksionale zbatimin me rigorozitet te parashikimeve te LP P dhe Rr PP ne menyre qe te plotesoje kerkesat e veta per mallra apo sherbimet etj., dhe me paste sigurohet qe ofertat ekonomike te paraqitura nga OE te ndryshme te plotesojne kerkesat e bera ne DST nga AK sipas percaktimeve te nenit 53, pika 3, 4, 5/c, dhe nenit 54 te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, te VKM Nr. 914, date 29.12.2014 per "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik ", te ndryshuar, theksojme perpara jush se: Ne DST eshte kerkuar implanti koklear por dhe paisje aksesore te cilat duhet te shoqerojne implantin koklear e konkretisht ne Shtojcen 10 te specifikimeve teknike jane kerkuar disa elemente nga te cilet qartesisht kuptohet qe nuk eshte aparati koklear i vetem por dhe pjese te tjera pa te cilat aparati koklear do te humbiste rendesine e tij dhe nuk do te realizonte funksionin e tij. Per te kuptuar qe ne DST jane kerkuar dhe pjese aksesore/perberese te rendesishme dhe nuk eshte kerkuar vetem implanti koklear sjellim te dhenat si me poshte:

1. Ne Shtojcen 10 eshte kerkuar. Garanci implanti te pakten 10 vjet.

Garancia per procesorin e zerit te pakten 3 vjet. (dukshem qe nuk kerkohet vetem implanti koklear por dhe paisje tjeter me garanaci ndryshe nga implanti koklear);

2. Ne piken 6 te shtojces 10 te DST eshte kerkuar: Mundesia per te dhene nje procesor zeri OTE qe nuk prek veshin (ne rastin e problemeve te kycit te nofulles ose syzeve);

3. Ne piken 9 te shtojces 10 te DST eshte kerkuar: Sistemi i implantit koklear te jete I paiisur me telekomande per kontrollin ne distance te procesorit te zerit.

4. Ne piken 9 te shtojces 10 te DST eshte kerkuar: Implanti duhet te jete me kellef titaniumi te marresit/stimulatorit.

5. Ne piken 21 te shtojces 10 te DST eshte kerkuar: "Cdo Implant duhet te jete i shoqeruar me Instrumentet pershtates dhe kirurgjikale i cili duhet te ofrohet falas, 1 set (Ne kete set duhet te perfshihen te gjitha instrumentet pershtatese dhe kirurgjikale qe nevojiten specifikisht per implantin koklear dhe elektroden qe do te implantohet. Seti me te gjitha pajisjet kerkohet te ofrohet falas, duke patur parasysh se cdo prodhues ka ne portofolin e produkteve te tij edhe setin e instrumenteve pershtates dhe kirurgjikale qe ndihmojne per nje vendosje sa me profesionale dhe cilesore te elektrodesh dhe implantit koklear. Per saktesim, nuk kerkohen instrumente te pergjithshme kirurgjikale, por vetem instrumente specifike te prodhuesit lidhur me implantin koklear.)"

- Nga specifikimet teknike te kerkuara rezulton qartesisht qe nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk eshte kerkuar vetem implanti koklear por dhe pjese aksesore te cilat lidhen ngushtesisht me implantin koklear per mirefunksionimin e tij, ndaj argumenti i Autoritetit Kontraktor qe ne DST nuk ka te percaktuar pjese perberese apo aksesore te Implantit Koklear per te cilet edhe mund te parashikohet TVSH-ia eshte i pavertete pasi qartesisht dalin ne pah pjeset perberese qe jane kerkuar nga Autoriteti Kontraktor dhe qe pranohet nga AK qe kane dhe TVSH. Dhe ashtu sic kemi theksuar dhe ne ankimin e paraqitur ne Autoritetin Kontraktor shprehur me baze ligjore vetem implanti koklear eshte i perjashtuar nga TVSH ndersa pjeset e tjera perberese dhe aksesore te implantit koklear jane me TVSH dhe nuk ka asnje dispozite ligjore qe ta perjashtoje pjeset perberese/aksesore nga TVSH-ia.

VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", ne nenin 27 pika 1, "Kontratat e Mallrave" parashikon se: "Specifikimet teknike duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 23 te LPP dhe qe i vlereson mallrat si te pranueshme per funksionet e kerkuara. Padyshim qe pjeset aksesore te kerkuara nga AK jane konform ligjit dhe qellimit te mire per efikasitetin e perdorimit te implantit koklear dhe ne si operatore ekonomike ne asnje moment nuk kundershtojme specifikimet e kerkuara, por nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk mund te shprehet qe nuk jane kerkuar pjese perberese dhe aksesore te implantit koklear pasi ato tashme jane te shprehura konkretisht ne DST ashtu sic eshte shprehur dhe me lart. Ajo qe ne kerkuam nga Autoriteti Kontraktor eshte ri-verifikimi i formularit te ofertes ekonomike te operatorit O.E.S Distrimed. Argumentimi i Autoritetit kontraktor qe 'Per sa i perket deklarimit apo jo te TVSH nga nje operator ekonomik, ky tager ligjor nuk eshte kompetence as e KVO, as e KSHA apo AK ne teresi, pasi AK nepermjet shpalljes/publikimit te DST-ve, dhe me tej nepermjet KVO apo edhe KSHA, ka per detyre funksionale zbatimin me rigorozitet te parashikimeve te LPP dhe RrPP ne menyre qe te plotesoje kerkesat e veta per mallra apo sherbimet etj., dhe me pas te sigurohet qe ofertat ekonomike te paraqitura nga OE te ndryshme te plotesojne kerkesat e bera ne DST nga AK' eshte absolutisht i gabuar pasi eshte vete Autoriteti Kontraktor i cili ne formularin e ofertes ekonomike ne shtojcen 1 te DST ka percaktuar qe cdo operator ekonomik duhet te shprehe pershkrimin e mallrave, Cmimin total i ofertes [monedha dhe vlere e ofertes]; pa TVSH dhe Cmimi total i ofertes [monedha dhe vlere e ofertes]; me TVSH.

-Qofte KVO qofte KSHA ka per detyre verifikimin nese cdo operator ekonomik i ploteson keto kritere te kerkuara apo jo. Nese operatori ekonomik nuk i ploteson keto kritere pa dyshim qe eshte shkak per skualifikimin e tij nga kjo Procedure Prokurimi. Eshte L.P.P e cila ne nenin 53 pika 3 te saj percakton qe: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit

-Neni 53, pika 5 germa c percakton qe: "Autoriteti Kontraktor nuk e pranon nje oferte: kur oferta e tij nuk perputhet me specifikimet e percaktuara ne dokumentet e tenderit, me perjashtim te rasteve te parashikuara ne nenin 54 te ketij ligji.

-Neni 55, pika 2 e L.P.P- se percakton qe: "Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per te percaktuar oferten fituese, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nuk duhet te perdoret asnje kriter, qe nuk eshte perfshire ne dokumentet e tenderit.

- Gjithashtu VKM Nr. 914, date 29.12.2014 per "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ne nenin 66, pika 3 percakton qe: "Komisioni i vleresimit te ofertave verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit.

- Nga teresia e bazave ligjore te siperpermendura eshte qartesisht e dukshme qe eshte detyre e KVO dhe Autoritetit Kontraktor qe te beje verifikim te ofertes ekonomike sipas kritereve qe ka percaktuar ne DST dhe eshte absurde argumenti qe nuk ka tager ligjor per verifikimin e TVSH kur eshte vete AK e cila percakton ne formularin e ofertes ekonomike qe Operatori ekonomik duhet te percaktoje dhe vleren e tvsh per produkte me TVSH.

-Mos verifikimi nga ana e Autoritetit kontraktor e pretendimeve tona ben qe Autoriteti Kontraktor te jete jo i barabarte, jo transparent dhe te kete nje argumentim kunder cdo parashikimi ligjor i cili i ka ngarkuar detyra per ushtrimin e funksionit te tyre.

- Kodi i Procedures Administrative ne nenin 77, pika 3 percakton qe: 3. Pervese kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet qe vertetojne akte, fakte, cilesi apo gjendje subjektive, te nevojshme per zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga organi qe zhvillon proceduren administrative, kur jane ne administrim te tij apo te organeve te tjera publike. Organi publik mund t'i kerkoje pales vetem elementet e nevojshme per identifikimin e tyre.

- Ne nenin 57, pika 1 (Administrimi i informacionit ne process) te L.P.P-se percaktohet qe: Pas hapjes se ofertave, pa cenuar detyrimet e percaktuara ne nenin 21 te ketij ligji, informacionet per shqyrtimin, sqarimin, vleresimin e ofertave dhe rekomandimet per oferten fituese nuk u behen te njohura ofertuesve ose personave te tjere, qe nuk jane te angazhuar zyrtarisht ne kete proces, derisa te nenshkruhet kontrata.

- Pra nga kjo del ne pah qe formulari i ofertes ekonomike i paraqitur nga O.E.S Distrimed nuk eshte dokument i cili nuk na behet i njohur deri ne nenshkrimin e kontrates ndaj dhe cdo pretendim i joni ngelet ne dyshim pasi cdo dokument, fakt qe mund te ndihmoje ne zgjidhjen e ceshtjes eshte tek Autoriteti Kontraktor prandaj dhe pritej te vertetohej nga ana e Autoritetit Kontraktor e cila jo vetem qe nuk e ri-verifikoi formularin e ofertes ekonomike te paraqitur nga O.E.S Distrimed por argumenton qe nuk ka tager ligjor per verifikimin e ofertes ekonomike dhe rishikimin nese kjo oferte eshte sipas kriterëve te percaktuara ne DST.

- Ashtu sic dhe AK ne shqyrtimin e ankimit thekson parimin e bashkepunimit, ne kuader te Kodit te Procedures Administrative, konkretisht nenit 78 (Bashkepunimi gjate hetimit administrativ), pika 1 ku citohet se: "Pala bashkepunon me organin publik ne percaktimin e fakteve dhe rrethanave te nevojshme per zgiidhien e ceshtjes", nga ana jone po jepen rrethana te cilat me ndihmen e Autoritetit Kontraktor mund te cojne ne zgjidhje te problemit dhe trajtim te barabarte, transparent dhe te drejte nga ana e AK.

Duke qene se Autoriteti Kontraktor nuk mori parasysh pretendimin tone per ri-verifikim te ofertes se operatorit ekonomik Theksojme dhe njehere perprapa Jush rrethanat si me poshte:

-Nisur nga fakti qe nje nga elementet kryesor te Prokurimit eshte Formulari i Ofertes ekonomike duam te veme ne dukje disa pika qe ngrene dyshime mbi menyren e vleresimit nga ana e Komisionit te vleresimit te ofertave. Ne rastin objekt prokurimi eshte percaktuar Cmimi per njesi per Marreveshjen Kuader eshte: 3,096,250 (tre milion e nentedhete e gjashte mije e dyqind e pesedhete) Leke pa TVSH, kjo vlere nenkupton totalin e cmimeve te perllogaritura me cmim per njesi.

- Referuar cmimit per njesi dhe formulareve te ofertave te paraqitura nga ana e operatoreve ekonomik Komisioni i vleresimit te ofertave duhet te bente vleresim te sakte te ofertave duke kryer detyren e tij funksionale e cila percaktohet ne Ligji Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe ne VK.M Nr. 914, date 29.12.2014 per "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar neni 58 parashikon qe "Komisioni eshte pergjegjes vetem per shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave ...".

- Duke here nje analize te hollesishme te produktit qe ofertohet nga cdo shoqeri pjesemarrrese ne tender vlen te theksojme se implanti koklear eshte nje pajisje komplekse e cila ben pjese ne nje kategori shume specifike te pajisjeve mjekesore, ate te Pajisjeve Mjekesore te Implantueshme

Aktive dhe eshte e shoqeruar dhe nga pjeset perberese/aksesore te saj. Ligj nr. 92/2014 "Per tatimin mbi vleren e shtuar ne Republiken e Shqiperise" ne nenin 51 germa b) ka percaktuar qe: "Jane furnizime te perjashtuara nga TVSH-ja transaksionet me interes te pergjithshem si me poshte: b) furnizimi i barnave, pajisjeve mjekesore te implantueshme aktive dhe pajisjeve mjekesore te implantueshme. Udhezimi nr. 6, date 30.01.2015 "Per tatimin mbi vleren e shtuar ne Republiken e Shqiperise" ka percaktuar cilat jane aparaturat mjekesore te cilat perjashtohen nga pagimi i TVSH. Ne nenin 38 (faqe 105) te ketij udhezimi percaktohet qe eshte e perjashtuar nga TVSH Implanti Koklear me kod NMK 90214000100. Pra qartesisht dallohet qe pjeset perberese sic eshte Mikrofoli, Magnetet, Telefoni me komandim ne distance etj nuk kane kode doganore dhe nuk jane te perjashtuara nga TVSH. Nga kjo rezulton qe vete implanti koklear eshte produkt i cili eshte i perjashtuar nga pagimi i TVSH, ndersa paisjet perberese/aksesore te tij jane produkte per te cilat perlllogaritet dhe vlera e TVSH.

- Nga vleresimi i tenderit sipas te cilet jane renditur dhe Operoret ekonomike te kualifikuar jane paraqitur dhe vlerat e ofertuara. Per subjektin O.E.S Distrimed rezulton se eshte paraqitur cmimi njesi ne vlere 2,767,500 Leke pa TVSH. Lidhur me cmimin e ofruar nga ky operator ekonomik i kemi kerkuar KSHA te beje verifikime te formularit te ofertes duke u mbeshetur ne dy pika kryesore te shprehura si me poshte:

I. Te behet verifikimi i formularit te ofertes ekonomike te O.E.S Distrimed nese ne kete formular e ka shprehur vleren e TVSH per paisjet aksesore/ perberese te cilat shoqerone implantin koklear dhe per te cilat duhet te paguhet TVSH. Nese operatori ekonomik O.E.S Distrimed ne formularin e ofertes ka deklaruar vleren e TVSH 0 Leke ndodhemi perpara faktit qe kemi mos deklarim te sakte te vleres se TVSH nga operatori ekonomik O.E.S Distrimed duke sjelle si pasoje mospagimin te taksave ose detyrimeve per perfitimin e sherbimeve ose moskryerja e kerkesave te detyrueshme, sic eshte mos kryerja e pagesave te TVSH qe bien ne kundertshtim me dispozitat ligjore ne fuqi. Ashtu sic u citua me lart i vetmi Kod NMK ose HS Code sic njihet nderkombetarisht i perjashtuar nga TVSH eshte 90214000100 qe ne rastin konkret eshte elektroda e cila implantohet ne Koklea (implanti koklear), pra vetem Implanti Koklear. Ne asnje dispozite ligjore nuk eshte e shprehur qe nga TVSH perjashtohen dhe materiale te tjera te domosdoshme qe shoqerone Implantin Koklear. Komisioni i Shqyrtimit te ankesave me ri-kontrollimin e Formularit te Ofertes ekonomike lehtesisht verifikon nese O.E.S Distrimed ka deklaruar TVSH per pjeset perberese te implantit Koklear apo jo. Nese nuk ka deklaruar TVSH ne formularin e ofertes per pjeset perberese automatikisht jemi ne kushtet e skualifikimit te ketij operatori ekonomik sepse shkelen dispozitat e legjislacionit tatimor, doganor por dhe Rregullave te Prokurimit Publik dhe Shtojces 1 (faqe 16) te DST e cila pervec se kerkon nje pershkrim te produkteve kerkon vleren Neto dhe TVSH e dhe ne fund totalin e ketij produkti duke perfshire dhe produktin pa TVSH dhe produktin me TVSH. Udhezimi nr. 6, date 30.01.2015 "Per tatimin mbi vleren e shtuar ne Republiken e Shqiperise" ka percaktuar cilat jane aparaturat mjekesore te cilat perjashtohen nga pagimi i TVSH. Ne nenin 38 (faqe 105) te ketij udhezimi percaktohet qe eshte e perjashtuar nga TVSH Implanti Koklear me kod NMK 90214000100. Pra qartesisht dallohet qe pjeset perberese sic eshte Mikrofoli, Magnetet, Telefoni me komandim ne distance etj nuk kane kode doganore dhe nuk jane te perjashtuara nga TVSH. Nga kjo rezulton qe vete implanti koklear eshte produkt i cili eshte i perjashtuar nga pagimi i TVSH, ndersa paisjet perberese/aksesore te tij jane produkte per te cilat perlllogaritet dhe vlera e TVSH.

II. Nese marrim te mireqene faktin qe operatori ekonomik O.E.S Distrimed ka ofertuar dhe vleren e TVSH i kemi kerkuar KSHA te verifikoje nese vlere e TVSH eshte shprehur dhe ne cmimin total sipas kerkeses se DST, Kriteret e vecanta te kualifikimit, pika a) Ku percaktohet qe "Formulari i Ofertes", sipas Shtojces 1 (te plotesohet me te dhenat per sasine e pritshme, cmimin per njesi dhe vleren e pritshme te kontrates per objektin e prokurimit); Lidhur me kete dyshim theksojme se Komisioni i shqyrtimit te ankesave duhet te bente nje rivleresim te situates se perllogaritjes se ofertes se paraqitur nga O.E.S Distrimed;

-Neni 14 i VKM Nr. 914, date 29.12.2014 per "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", Gjate pergatitjes se ofertave, kandidatet ose ofertuesit duhet te perfshijne te gjitha detyrimet fiskale, qe jane ne fuqi deri ne 28 (njetzet e tete) dite para hapjes se ofertave, me perjashtim te TVSH-se, e cila, nese eshte e aplikueshme, do te llogaritet mbi vleren e ofertes. Bazuar ne ligj operatori ekonomik ne formularin e vleresimit te ofertes duhet te perfshije dhe llogaritjen e TVSH e cila eshte e aplikueshme per pjeset perberese/aksesore te implantit koklear. Nese operatori ekonomik O.E.S Distrimed nuk ka percaktuar ne formular oferte dhe vleren e TVSH ateher kjo tregon qartesisht qe KVO nuk ka vleresuar sic duhet oferten ekonomike dhe nuk ka marre parasysht qe mungesa e percaktimit te TVSH ne kete formular perben shkak per skualifikim te ketij operatori ekonomik, pasi ky operator ekonomik paraqet nje oferte ekonomike duke mos paguar detyrimet tatimore dhe taksat e vendosura sipas ligjit.

- Operoret ekonomike duhet te plotesojne ofertat e tyre duke patur parasysht nevojat sasiore dhe fondet limit per cdo autoritet kontraktor, te percaktuara ne tabelen e pergjithshme dhe tabelat e vecanta me te dhenat e paraqitura (ne shtojcen 1) te dokumentave standarte te tenderit. Tejkalimi i fondit per cdo autoritet kontraktor eshte kusht skualifikues.

- Autoriteti kontraktor gjate shqyrtimit te ofertave duhet te jete ne respektim te dispozitave ligjore, perfshire edhe dispozitave te nenit 53, pika 2 te LPP [...].

-Gjithashtu kerkojme vleresim te ofertes ekonomike sepse nese operatori ekonomik ka TVSH per produktet qe oferton ateher nepermjet perllogaritjes mund te rezultojte qe cmimi i ofruar tejkalon limitin per cmim njesi te percaktuar nga DST.

- Ne nenin 46, pika 1, te Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese".

- Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme.

- KVO ka kualifikuar nje operator ekonomik i cili jep nje oferte ekonomike pervec se nese llogaritet vlere e TVSH eshte me e larte se cmimi per njesi i kerkuar, nese paraqitet TVSh 0 leke duke bere qe ky operator te shkele normat ligjore nepermjet shmangies se pagimit te detyrimeve TVSH per sherbimin e marre.

-Sipas nenit 45 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ne kushtet kur nese vleresohet dhe rishikohet formulari i ofertes ekonomike te paraqitur nga ky operator

ekonomik dhe rezulton qe dyshimi jone eshte i vertete jemi perpara kushteve te skualifikimit te ketij operatori ekonomik.

Se dyti, lidhur me argumentimin e dyte te Autoritetit Kontraktor per Operatorin ekonomik Evita sh.p.k., "KSHA vlereson se e gjitha gama e ankimit eshte e ndertuar dhe referohet vetem mbi bazen e informacionit qe OE Ankues "FEDOS" Shpk., pretendon se disponon, si dhe ndertohet mbi dyshime te OE Ankues per menyren e ndertimit te Ofertes se OE Evita Shpk., per te cilen citon se eshte oferte e dyshimte nese i ploteson specifikimet teknike apo jo, per shkak te ofertes se ulet financiare me te cilen OE Evita ka ofertuar...", theksojme se:

-Kemi kerkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor te beje verifikime te produktit te ofertuar nga ana e operatorit Ekonomik Evita sh.p.k ne vlere 1,667,500 leke. Oferta e paraqitur nga ky operator ekonomik krijon dyshime nese operatori ka ofertuar modelin e produktit qe permbush te gjitha specifikimet teknike te kerkuara. Dyshimet lidhur me plotesimin e kriterëve nga ky operator ekonomik lindin per arsytet e meposhtme:

- Per implantin koklear jane vetem 3 prodhues ne te gjithë boten dhe pjeset perberese te paisjes jane praktikisht te njejte ne numer, element ky qe ben te thjeshte krahasimin e vlerave monetare te seciles pjese perberese te produktit.

- Bazuar ne fakti qe prokurimi lidhur me Implantin Koklear behet per here te dyte dhe nga vendimi i pare i KPP nr. 326/2019 per operatorin ekonomik Evita sh.p.k eshte vendosur mos pranimi i ankimit sepse nga ana e operatorit Evita sh.p.k nuk plotesohen kerkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktor. Nderkohe qe ky operator ekonomik shpallet fitues ne vend te pare ne ceshtjen objekt prokurimi duke ofruar produktin me nje vlere me te ulet dhe gje e cila ben te kemi dyshime te arsyeshme qe ky operator ekonomik ofron produktin nga i njejti prodhues dhe bazuar ne cmimin e tregut eshte e pamundur qe te ofrohen/plotesohen specifikimet teknike te kerkuara me nje cmim si ai i paraqitur nga operatori ekonomik Evita sh.p.k. Pra baza e ankimit tone eshte nje vendim i meparshem KPP lidhur me kete procedure prokurimi. Ndaj AK ka detyrimin e hetimit te thelle administrativ dhe jo ne menyre siperfaqesore te shpalle fitues nje operator ekonomik pa verifikuar specifikimet qe ky operator ekonomik ploteson.

- Specifikimet teknike te cilat krijojne dyshime nese zbatohen dhe perputhen me kerkesat e DST nga ky operator ekonomik jane Specifikimet teknike te pikave 8, 13, 15,17 dhe 21. Fokusi kryesor vihet ne keto specifikime pasi keto jane specifikime te cilat kane kosto financiare dhe duke pare cmimin e ofruar nga Evita sh.p.k krijohe dyshime nese oferta e paraqitur i perfshin kostot financiare te ketyre specifikimeve apo jo.

- Fillimisht kerkojme te verifikohet nese operatori Evita sh.p.k ka ofertuar aksesoret per procesorin e zerit te cilet e bejne rezistent kunder ujit sipas standarteve IP68. Pika 8 - Mundesia per te dhene nje procesor zeri kundra ujit (ëaterproof). Theksojme qe te gjithë procesoret e zerit duhet te vishen me aksesor special per te realizuar mbrojtjen kunder ujit dhe Modelet baze te procesoreve nuk e kane te perfshire. Kerkojme qe te shikohet nese vlere financiare e ketij aksesori eshte e perfshire ne oferten e operatorit ekonomik.

- Ne te njejten llogjike kerkojme verifikime per piken 13 - Implanti duhet te kete me kellef titaniumi te marresit/stimulatorit. Pasi dhe ne kete rast kemi te bejme me ofertim te versioneve standarte ose te versionit qe perfshin kete aksesor.

- Gjithashtu kerkojme nga KSHA te bej verifikime nese funksionet sipas pikave 15 - Rezonance Magnetike 1.5 deri ne 3 T pa pasur nevojte te hiqet magneti nga trupi i implantit dhe 17 - Identifikim

elektronik ndermjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkembimin aksidental te procesorit te zerit nga paciente te ndryshem ose nga ane te ndryshme dhe nese plotesohen dhe nese jane perfshire ne dokumentacionet plotesues te ofertes ekonomike. Ne lidhje me piken 15 i kerkojme te verifikohet nese Operatori ekonomik Evita sh.p.k ka ofertuar versionin qe suporton Rezonancen 3T qe aktualisht eshte e instaluar prane QSUT. Mos ofertimi i ketij funksioni ka ndikim si nga ana financiare e ofertes ashtu dhe tek pacientet te cileve i mohohet e drejta per te perdorur sherbimet spitalore te nje rendesie te vecante sic eshte MRI 3T. Gjithashtu mungesa e funksionit sipas pikes 17 kufizon pacientet qe te jene ne kontakt ose ne afersi me persona te tjere qe perdorin te njejten paisje duke mos i plotesuar te plote sherbimin qe i eshte ofertuar.

- Kemi kerkuar gjithashtu te verifikohet nese OE ka marre deklarate nga prodhuesi qe te mbuloje shpenzimet per plotesimin e pikes, 21 Cdo Implant duhet te jete i shoqeruar me Instrumentet pershtates dhe kirurgjikale i cili duhet te ofrohet falas, 1 set.

- Pra sic u citua me lart te gjitha keto specifikime teknike kane kosto financiare per te cilat i kemi kerkuar KSHA te beje verifikimet nese jane perfshire ne oferten perfundimtare prej 1,667,500 Leke nga OE.

- Ne nenin 53/3 te LPP-se percakohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit..." Autoriteti Kontraktor dhe KVO duhet te tregohej konkrete, e drejte dhe te beje verifikimin e duhur nese ky operator ekonomik i ploteson te gjitha kriteret e percaktuara sepse fakti qe cmimi i ofruar eshte i ulet dhe kostoja financiare e disa prej specifikimeve teknike eshte e larte na ve perpara dyshimit qe Operatori ekonomik jep nje cmim te ulet dhe nuk ploteson keto specifikime teknike qe kerkohen ne DST ose Operatori ekonomik ka nje oferte anomalisht te ulet krahasuar me dy operoret e tjere ekonomike. Per Evita sh.p.k duhet te verifikohet qartesisht oferta e tij duke studiuar anen ekonomike te metodes se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara gjithashtu dhe origjinaliteti i sherbimit te kerkuar pasi Pjeset perberese te implantit koklear dhe specifikimet teknike qe kerkohen kane ndikim te drejtperdrejte ne kosto financiare te produktit te ofertuar.

- Specifikimet teknike duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 23 te LPP dhe qe i vlereson mallrat site pranueshme per funksionet e kerkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar. Ne legjislacionin e prokurimit publik, eshte percaktuar qartesisht se, operoret ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi duhet te paraqesin dokumentacionin e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor dhe KVO eshte pergjegjese per vleresimin e ketij informacioni dhe kerkimin e informacioneve. Fakti qe Komisioni i shqyrtimit te ankesave ne Autoritetin Kontraktor nuk ka kthyer pergjigje ankimit tone shton me tej dyshimin per vertetesine e pretendimeve te siperpermendura nga ana jone. Ne nenin 46, pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se: "[...] Operoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktori vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohetdhe jodiskriminuese.

Autoriteti Kontraktor ka vendosur kualifikim e dy shoqerive Evita sh.p.k dhe O.E.S Distrimed pa

verifikuar nese plotesojne kriteret e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor ne DST. Kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates dhe rrjedhimisht ky i fundit do te konsideroje nje oferte te vlefshme, nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, por nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave nuk jane vleresuar dhe verifikuar dokumentacionet perkatese te ngarkuara online.

Shoqeria Fedos sh.p.k i ka realizuar keto kritere e konkretisht kualifikimet teknike dhe kriteret e pergjithshme dhe duke permiresuar punen ne te gjitha specifikimet teknike duke paraqitur perpara Komisionit te Vleresimit te Ofertave dhe Autoritetit Kontraktor dokumentacionet e duhura sipas natyres se produktit qe kerkohet. Oferta e paraqitur nga shoqeria Fedos sh.p.k eshte plotesisht e rregullt dhe brenda kerkesave te vendosura ne DST, si dhe perben leverdisshmeri ekonomike per Autoritetin Kontraktor.

Gjendur perpara dyshimeve te argumentuara dhe te arsyeshme qe operatoret ekonomike O.E.S Distrimed dhe Evita sh.p.k kane shkelje ne procedurat e tyre te prokurimit ne oferten ekonomike dhe ne specifikimet teknike, Kerkojme qe Komisioni i Prokurimit Publik te marre per baze ankesen tone per kete procedure te paraqitur me lart, pasi nepermjet kualifikimit te ketyre operatoreve ekonomike shoqerise FEDOS demtohet nga nje vendim i autoritetit kontraktor, i marre ne kundersizim me kete ligj. Kjo gje ben qe vendimi i marre nga KVO te jete ne shkelje te nenit 2 te L.P.P-se i cili percakton qe: Perzgjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve; b) transparence ne procedurat e prokurimit; c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve.

Duke kualifikuar dhe dy operatoret e tjere ekonomike pavaresisht se nuk plotesojne kriteret e percaktuara ne DST, KVO ben diskriminim ndaj operatorit ekonomik FEDOS i cili ka plotesuar te gjitha kriteret e percaktuara ne DST duke e renditur si fitues te dytin, ndersa KSHA tregohet jo transparente duke mos kthyer nje pergjigje per ankimin e paraqitur nga ana jone.

Ndodhur ne kushtet e sipercituara kerkojme: Pranimin e ankeses tone, ri-verifikimin e Ofertes se paraqitur nga Operatori ekonomik O.E.S Distrimed, dhe Evita sh.p.k, skualifikimin e ketyre shoqerive nga kjo procedure prokurimi dhe shpalljen fitues te pare shoqerise Fedos sh.p.k, pasi qendrimi i KVO eshte devijim total dhe shkelje e LPP dhe e kerkesave e specifikimeve te kerkuara ne DST.

Kerkojme pranimin e ankeses tone, ri-verifikimin e Ofertes se paraqitur nga Operatori ekonomik O.E.S Distrimed, dhe Evita sh.p.k, skualifikimin e ketyre shoqerive nga kjo procedure prokurimi dhe shpalljen fitues te pare shoqerine Fedos sh.p.k, pasi qendrimi i KVO eshte devijim total dhe shkelje e LPP dhe e kerkesave e specifikimeve te kerkuara ne DST.

II.7. Në datën 12.11.2019, nëpërmjet shkresës me nr.3570/7 prot., datë 11.11.2019, me objekt: “Informacion sqarues në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.1685/1 Prot., datë 01.11.2019, nga autoriteti kontraktor, sa i përket procedurës së prokurimit me nr. REF-33686-08-16-2019, me objekt: “Blerje materiale specifike të ORL/ Implanti Koklear”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Fedos” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k. me arsyetimin se [...] *Specifikimet teknike te cilat krijojne dyshime nese zbatohen dhe perputhen me kerkesat e DST nga ky operator ekonomik jane Specifikimet teknike te pikave 8, 13, 15, 17 dhe 21. Fokusi kryesor vihet ne keto specifikime pasi keto jane specifikime te cilat kane kosto financiare dhe duke pare cmimin e ofruar nga Evita sh.p.k krijojen dyshime nese oferta e paraqitur i perfshin kostot financiare te ketyre specifikimeve apo jo. - Fillimisht kerkojme te verifikohet nese operatori Evita sh.p.k ka ofertuar aksesoret per procesorin e zerit te cilet e bejne rezistent kunder ujit sipas standarteve IP68. Pika 8 - Mundesia per te dhene nje procesor zeri kundra ujit (ëaterproof). Theksojme qe te gjithë procesoret e zerit duhet te vishen me aksesor special per te realizuar mbrojtjen kunder ujit dhe Modelet baze te procesoreve nuk e kane te perfshire. Kerkojme qe te shikohet nese vlera financiare e ketij aksesori eshte e perfshire ne oferten e operatorit ekonomik.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Shtojca 1, “Formulari i ofertës ekonomike”, përcaktohet:

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia			Afati

			Çmimi Njësi	Çmimi Total	
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika c dhe f, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“c) Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme per artikullin objekt prokurimi (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te përcaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

f) Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike, per artikujt e kerkuar ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.”

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, “Specifikimet teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Nr.	Materiali mjekësor	Specifikimet teknike
1.	Implant Koklear	1. Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm.
		2. Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.
		3. Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.
		4. Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).

	5. <i>Fuqia e impaktit të shtresës së implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.</i>
	6. <i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kështu të nofullës ose syzeve).</i>
	7. <i>Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, të jete e rregullueshme në disa nivele.</i>
	8. <i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).</i>
	9. <i>Sistemi i implantit koklear të jete i pajisur me telekomandë për kontrollin në distancë të procesorit të zërit.</i>
	10. <i>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</i>
	11. <i>Numri i burimeve të rrymës në implant duhet të jete i barabartë ose më i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.</i>
	12. <i>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion të ndryshimit automatik të programit, pa pasur nevojë të rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).</i>
	13. <i>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi të marrësit/stimulatorit.</i>
	14. <i>Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar (sipas nevojave të shërbimit). Të mundësohen elektroda të drejta ose të paraharkuara.</i>
	15. <i>Rezonancë Magnetike 1.5 deri në 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</i>
	16. <i>Mundësi e heqjes së përkohshme të magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.</i>
	17. <i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.</i>
	18. <i>Mundësi e dhënies së procesorit të zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkuorporuar për stimulim elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</i>
	19. <i>Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkuorporuar.</i>
	20. <i>Procesori i zërit BTE të ofroje mundësinë që të komunikojë me një mikrofonin eireless kontralateral të vendosur në veshin që nuk ka impiant.</i>
	21. <i>Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale të cilat duhet të ofrohet falas, 1 set. (Në këtë set duhet të përfshihen të gjitha instrumentet përshtatëse dhe kirurgjikale që nevojiten specifikisht për implantin koklear dhe elektrodën që do të implantohet. Seti me të gjitha pajisjet kërkohet të</i>

		<i>ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues ka ne portofolin e produkteve te tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale qe ndihmojnë për një vendosje sa me profesionale dhe cilësore te elektrodës dhe implantit koklear. Për saktësim, nuk kërkohen instrumente te përgjithshme kirurgjikale, por vetëm instrumente specifike te prodhuesit lidhur me implantin koklear.)</i>
--	--	---

III.1.3. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimet”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

<i>Nr.</i>	<i>Materiali mjekësor</i>	<i>Specifikimet teknike</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Implant Koklear</i>	<i>Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm.</i>	<i>20</i>
		<i>Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.</i>	
		<i>Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.</i>	
		<i>Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).</i>	
		<i>Fuqia e impaktit të shtresës se implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.</i>	
		<i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kyçit të nofullës ose syzeve).</i>	
		<i>Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, te jete e rregullueshme ne disa nivele.</i>	
		<i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).</i>	
		<i>Sistemi i implantit koklear i pajisur me telekomandë për kontrollin ne distancë të procesorit të zërit.</i>	
		<i>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</i>	
		<i>Numri i burimeve te rrymës në implant duhet te jete i barabartë ose me i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.</i>	
		<i>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion te ndryshimit automatik te programit, pa pasur nevojte te rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).</i>	
		<i>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi te marrësit/stimulatorit.</i>	
		<i>Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënie e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar që do ti nënshtrohet implantit(sipas nevojave te sherbimit) Te mundesohen elektroda te drejta ose te paraharkuara</i>	

	<p><i>Rezonancë Magnetike 1.5 deri ne 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</i></p> <p><i>Mundësi e heqjes së përkohshme te magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.</i></p> <p><i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane te ndryshme.</i></p> <p><i>Mundësi e dhënies se procesorit te zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkorporuar për stimulim elektroacustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</i></p> <p><i>Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkorporuar.</i></p> <p><i>Procesori i zërit BTE te ofroje mundësinë qe te komunikojë me nje mikrofonin ëireless kontralateral te vendosur ne veshin qe nuk ka implant</i></p> <p><i>Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale i cili duhet të ofrohet falas, 1 set. (Ne këtë set duhet te përfshihen te gjitha instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale qe nevojiten specifikisht për implantin kokle dhe elektrodën qe do te implantohet. Seti me te gjitha pajisjet kërkohet te ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues ne portofolin e produkteve te tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale qe ndihmojnë për një vendosje sa profesionale dhe cilësore te elektrodës dhe implantit koklear. Në saktësim, nuk kërkohen instrumente te përgjithshme kirurgjike por vetëm instrumente specifike te prodhuesit lidhur me implantin koklear.)</i></p>	
--	--	--

Kontratat do te jepen brenda periudhës: nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuadër me OE te shpallur fitues, me afat përfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

Afatet e lëvrimit: QSUT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 mujor. Përyjashtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontrate të lidhur sipas përcaktimit më sipër afatet e lëvrimit do te jene si me poshtë:

- 15% e sasisë se kërkuar te objektit te prokuruar duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit te kontratës.*
- pjesa e sasisë se mbetur duhet te lëvrohet deri ne përfundim te kontratës dhe sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor.*

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formularin e ofertës ekonomike.

- Ofertë Teknike e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k., në të cilën pasqyrohen (Artikulli i kërkuar; Pajisja parësore; Komponentët; Referenca në specifikime; Kompania prodhuese; Origjina; Skadenca; Emërtimi në katalog; Referenca në katalog; Nr. referencës së artikullit; Certifikimi.)
- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
- Katalog “DL – Coil for Sonnet” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Synchrony ST Cochlear Implant Unparalleled MRI Safety” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Rondo Audio Processor” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Sonnet Audio Processor” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Synchrony ST Cochlear Implant” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;

III.1.5. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”*

III.1.6. Në nenin 23 pika 1, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : *“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

Gjithashtu në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.[...]”*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27 pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 27, pika 6 gërma “b” “Kontratat e Mallrave” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike”.*

Nga interpretimi telologjik (qëllimi i normës juridike) Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kërkesa për dorëzimin e katalogëve të produktit si një kërkesë e vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit i shërben autoritetit kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me produktin/produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.1.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konkretisht në shtojcën 10 "Specifikime teknike", për materialin mjekësor Implant koklear ka kërkuar "Mundësia për të dhënë një processor zëri kundra ujit (ëaterproof)". Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin katalogët për pajisjet mjekësore, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këto pajisje.

III.1.11. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Evita" sh.p.k., konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, katalogët e produkteve të ofruara, të përkthyer dhe të noterizuar, dokumentin "Ofertë Teknike" në të cilën pasqyrohen materialet mjekësore objekt prokurimi si dhe informacionet në lidhje me to, për sa i përket Kompanisë prodhuese; Origjinës së mallit; Skadencës së tyre; Emërtimi në Katalog; Numri i referencës (kodi); si dhe Certifikimet.

Konkretisht, operatori ekonomik "Evita" sh.p.k., për përmbushjen e kriterit "Mundësia për të dhënë një processor zëri kundra ujit (ëaterproof)", referuar deklaratës së tij në ofertën teknike, konstatohet se ky i fundit për specifikimin teknik nr.8, ka paraqitur dy Audio Procesorë, konkretisht Audio Procesori BTE dhe Audio Procesori OTE. Për secilin nga këto artikuj, operatori ekonomik "Evita" sh.p.k. ka paraqitur katalogët përkatës. Konkretisht, për Audio Procesorin BTE ka paraqitur katalogun origjinal dhe të përkthyer "Sonnet Audio Processor" MED EL në të cilin citohet se "procesori Sonnet është rezistent ndaj ujit..", ndërsa për Audio Procesorin OTE ka paraqitur katalogun origjinal dhe të përkthyer "Rondo Audio Processor" MED EL në të cilin citohet se "Veshja ujore është një mbulesë aksesor plotësisht i papërshkrueshëm nga uji..". Pra,

operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur vërteton se procesorët e zërit të paraqitur nga ana e tij plotësojnë specifikimin teknik në lidhje me kërkesën se këto të fundit duhet të jenë kundra ujit.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, se “*Kërkojmë që të shikohet nëse vlera financiare e këtij aksesori është e përfshirë në ofertën e operatorit ekonomik*”, nga verifikimi i ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., konstatohet se ky i fundit ka paraqitur formularin e ofertës sipas shtojcës 1, ku ka përfshirë në ofertën e tij totale edhe zërin për procesorë, së bashku me vlerën përkatëse, duke deklaruar në këtë mënyrë se ky i fundit, do të ofrojë të gjitha produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Pra sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron, pasi operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., në ofertën totale të paraqitur për këtë procedurë prokurimi ka përllogjitur edhe zërin për procesorë zëri sipas kërkesave të autoritetit kontraktor si dhe dispozitave ligjore përkatëse.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Fedos” sh.p.k., nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Fedos” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k. me arsyetimin se [...] *Ne te njejten llogjike kerkojme verifikime per piken 13 - Implanti duhet te kete me kellef titaniumi te marresit/stimulatorit. Pasi dhe ne kete rast kemi te bejme me ofertim te versioneve standarte ose te versionit qe perfshin kete aksesor.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, pika c dhe f, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“c) Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin objekt prokurimi (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për artikujt e kërkuar në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet përkatëse për produktet.”

III.2.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, “*Specifikimet teknike*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Nr.	Materiali mjekësor	Specifikimet teknike
1.	Implant Koklear	<ol style="list-style-type: none"> <li data-bbox="544 1732 1446 1808">1. Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm. <li data-bbox="544 1808 1446 1883">2. Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.

	<p>3. <i>Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.</i></p>
	<p>4. <i>Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).</i></p>
	<p>5. <i>Fuqia e impaktit të shtresës së implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.</i></p>
	<p>6. <i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kyçit të nofullës ose syzeve).</i></p>
	<p>7. <i>Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, të jete e rregullueshme në disa nivele.</i></p>
	<p>8. <i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).</i></p>
	<p>9. <i>Sistemi i implantit koklear të jete i pajisur me telekomandë për kontrollin në distancë të procesorit të zërit.</i></p>
	<p>10. <i>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</i></p>
	<p>11. <i>Numri i burimeve të rrymës në implant duhet të jete i barabartë ose më i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.</i></p>
	<p>12. <i>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion të ndryshimit automatik të programit, pa pasur nevojë të rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).</i></p>
	<p>13. <i>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi të marrësit/stimulatorit.</i></p>
	<p>14. <i>Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar (sipas nevojave të shërbimit). Të mundësohen elektroda të drejta ose të paraharkuara.</i></p>
	<p>15. <i>Rezonancë Magnetike 1.5 deri në 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</i></p>
	<p>16. <i>Mundësi e heqjes së përkohshme të magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.</i></p>
	<p>17. <i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.</i></p>
	<p>18. <i>Mundësi e dhënies së procesorit të zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkorporuar për stimulim elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</i></p>
	<p>19. <i>Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkorporuar.</i></p>
	<p>20. <i>Procesori i zërit BTE të ofroje mundësinë që të komunikojë me një mikrofonin eireless kontralateral të vendosur në veshin që nuk ka impiant.</i></p>

		<p>21. Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale i cili duhet të ofrohet falas, 1 set. (Ne këtë set duhet te përfshihen te gjitha instrumentet përshtatëse dhe kirurgjikale qe nevojiten specifikisht për implantin koklear dhe elektrodën qe do te implantohet. Seti me te gjitha pajisjet kërkohet te ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues ka ne portofolin e produkteve te tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale qe ndihmojnë për një vendosje sa me profesionale dhe cilësore te elektrodës dhe implantit koklear. Për saktësim, nuk kërkohen instrumente te përgjithshme kirurgjikale, por vetëm instrumente specifike te prodhuesit lidhur me implantin koklear.)</p>
--	--	--

III.2.3. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Nr.	Materiali mjekësor	Specifikimet teknike	Sasia
1	Implant Koklear	Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm.	20
		Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.	
		Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.	
		Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).	
		Fuqia e impaktit të shtresës se implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.	
		Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kyçit të nofullës ose syzeve).	
		Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, te jete e rregullueshme ne disa nivele.	
		Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).	
		Sistemi i implantit koklear i pajisur me telekomandë për kontrollin ne distancë të procesorit të zërit.	
		Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.	
		Numri i burimeve te rrymës në implant duhet te jete i barabartë ose me i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.	
Procesori i zërit duhet të jetë me funksion te ndryshimit automatik te programit, pa pasur nevojte te rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).			

	<p><i>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi te marrësit/stimulatorit.</i></p> <p><i>Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar që do të nënshtrohet implantit (sipas nevojave të shërbimit)</i></p> <p><i>Te mundësohen elektroda të drejta ose të paraharkuara</i></p> <p><i>Rezonancë Magnetike 1.5 deri në 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</i></p> <p><i>Mundësi e heqjes së përkohshme të magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.</i></p> <p><i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.</i></p> <p><i>Mundësi e dhënies së procesorit të zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkuorporuar për stimulim elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</i></p> <p><i>Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkuorporuar.</i></p> <p><i>Procesori i zërit BTE të ofroje mundësinë që të komunikojë me një mikrofonin eireless kontralateral të vendosur në veshin që nuk ka implant</i></p> <p><i>Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale i cili duhet të ofrohet falas, 1 set. (Në këtë set duhet të përfshihen të gjitha instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale që nevojiten specifikisht për implantin koklear dhe elektrodën që do të implantohet. Seti me të gjitha pajisjet kërkohet të ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues në portofolin e produkteve të tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale që ndihmojnë për një vendosje të saktë dhe cilësore të elektrodës dhe implantit koklear. Në saktësim, nuk kërkohen instrumente të përgjithshme kirurgjike por vetëm instrumente specifike të prodhuesit lidhur me implantin koklear.)</i></p>	
--	--	--

Kontratat do të jepen brenda periudhës: nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE të shpallur fitues, me afat përfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

Afatet e lëvrimit: QSUT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 muaj. Përbashkërisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër afatet e lëvrimit do të jene si më poshtë:

- 15% e sasisë së kërkuar të objektit të prokuruar duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.*

- pjesa e sasisë se mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Ofertë Teknike e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k., në të cilën pasqyrohen (Artikulli i kërkuar; Pajisja parësore; Komponentët; Referenca në specifikime; Kompania prodhuese; Origjina; Skadenca; Emërtimi në katalog; Referenca në katalog; Nr. referencës së artikullit; Certifikimi.)
- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
- Katalog “DL – Coil for Sonnet” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Synchrony ST Cochlear Implant Unparalleled MRI Safety” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Rondo Audio Processor” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Sonnet Audio Processor” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Synchrony ST Cochlear Implant” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;

III.2.5. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.2.6. Në nenin 23 pika 1, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Specifikimet teknike duhet të përshkruajjnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.[...]”.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajjnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27 pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 27, pika 6 gërma “b” “Kontratat e Mallrave” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike”.

Nga interpretimi telologjik (qëllimi i normës juridike) Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kërkesa për dorëzimin e katalogëve të produktit si një kërkesë e vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit i shërben autoritetit kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me produktin/produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.2.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.2.10. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konkretisht në shtojcën 10 “Specifikime teknike”, për materialin mjekësor Implant koklear ka kërkuar “*Implanti duhet të jetë me këllëf titanium të marrësit/stimulatorit*”. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin katalogët për pajisjet mjekësore, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këto pajisje.

III.2.11. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, Katalogët e produkteve të ofruara, të përkthyer dhe të noterizuar, dokumentin “Ofertë Teknike” në të cilën pasqyrohen Materialet mjekësore objekt prokurimi si dhe informacionet në lidhje me to për sa i përket Kompanisë prodhuese; Origjinës së mallit; Skadencës së tyre; Emërtimi në Katalog; Numri i referencës (kodi); si dhe Certifikimet.

Konkretisht, operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., për përmbushjen e kriterit “*Implanti duhet të jetë me këllëf titanium të marrësit/stimulatorit*”, referuar deklaratës së tij në ofertën teknike, konstatohet se për këtë specifikim operatori ekonomik “Evita” sh.p.k. ka paraqitur katalogun origjinal dhe të përkthyer “Synchrony ST Cochlear Implant Unparalleled MRI Safety” MED EL,

në të cilin citohet se Implanti Koklear Synchrony ST është “Implant i fortë titani...”. Sa më sipër, KPP gjykon se, nga verifikimi i këtij katalogu, konstatohet se Implanti Koklear Synchrony ST, i ofruar nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., është implant titani.

Pra, operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., ka paraqitur versionin Implant Koklear prej materiali titan, duke përmbushur më së miri qëllimin e vendosjes së kriterit nga ana e autoritetit kontraktor për sa i përket materialit të implantit. Rrjedhimisht dhe oferta ekonomike është paraqitur në përputhje me produktet e ofruara.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Fedos” sh.p.k., nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Fedos” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k. me arsyetimin se [...]Ne lidhje me piken 15 i kërkojme te verifikohet nese Operatori ekonomik Evita sh.p.k ka ofertuar versionin qe suporton Rezonancen 3T qe aktualisht eshte e instaluar prane QSUT. Mos ofertimi i ketij funksioni ka ndikim si nga ana financiare e ofertes ashtu dhe tek pacientet te cileve i mohohet e drejta per te perdorur sherbimet spitalore te nje rendesie te vecante sic eshte MRI 3T.”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika c dhe f, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“c) Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme per artikullin objekt prokurimi (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

f) Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike, per artikujt e kerkuar ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatese per produktet.”

III.3.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, “Specifikimet teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Nr.	Materiali mjekësor	Specifikimet teknike
1.	Implant Koklear	1. Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm.
		2. Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.
		3. Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.

	4. <i>Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).</i>
	5. <i>Fuqia e impaktit të shtresës së implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.</i>
	6. <i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kyçit të nofullës ose syzeve).</i>
	7. <i>Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, të jete e rregullueshme në disa nivele.</i>
	8. <i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).</i>
	9. <i>Sistemi i implantit koklear të jete i pajisur me telekomandë për kontrollin në distancë të procesorit të zërit.</i>
	10. <i>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</i>
	11. <i>Numri i burimeve të rrymës në implant duhet të jete i barabartë ose më i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.</i>
	12. <i>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion të ndryshimit automatik të programit, pa pasur nevojë të rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).</i>
	13. <i>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi të marrësit/stimulatorit.</i>
	14. <i>Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar (sipas nevojave të shërbimit). Të mundësohen elektroda të drejta ose të paraharkuara.</i>
	15. <i>Rezonancë Magnetike 1.5 deri në 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</i>
	16. <i>Mundësi e heqjes së përkohshme të magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.</i>
	17. <i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.</i>
	18. <i>Mundësi e dhënies së procesorit të zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkorporuar për stimulim elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</i>
	19. <i>Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkorporuar.</i>
	20. <i>Procesori i zërit BTE të ofroje mundësinë që të komunikojë me një mikrofonin ëireless kontralateral të vendosur në veshin që nuk ka impiant.</i>
	21. <i>Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale i cili duhet të ofrohet falas, 1 set.</i>

		<i>(Ne këtë set duhet të përfshihen të gjitha instrumentet përshtatëse dhe kirurgjikale që nevojiten specifikisht për implantin koklear dhe elektrodën që do të implantohet. Seti me të gjitha pajisjet kërkohet të ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues ka në portofolin e produkteve të tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale që ndihmojnë për një vendosje sa më profesionale dhe cilësore të elektrodës dhe implantit koklear. Për saktësim, nuk kërkohen instrumente të përgjithshme kirurgjikale, por vetëm instrumente specifike të prodhuesit lidhur me implantin koklear.)</i>
--	--	--

III.3.3. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimet”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

<i>Nr.</i>	<i>Materiali mjekësor</i>	<i>Specifikimet teknike</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Implant Koklear</i>	<i>Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm.</i>	<i>20</i>
		<i>Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.</i>	
		<i>Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.</i>	
		<i>Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).</i>	
		<i>Fuqia e impaktit të shtresës së implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.</i>	
		<i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kyçit të nofullës ose syzeve).</i>	
		<i>Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, të jete e rregullueshme në disa nivele.</i>	
		<i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).</i>	
		<i>Sistemi i implantit koklear i pajisur me telekomandë për kontrollin në distancë të procesorit të zërit.</i>	
		<i>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</i>	
		<i>Numri i burimeve të rrymës në implant duhet të jete i barabartë ose më i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.</i>	
		<i>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion të ndryshimit automatik të programit, pa pasur nevojë të rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).</i>	
<i>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi të marrësit/stimulatorit.</i>			

	<p><i>Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar që do të nënshtrohet implantit (sipas nevojave të shërbimit)</i></p> <p><i>Te mundesohen elektroda të drejta ose të paraharkuara</i></p>	
	<p><i>Rezonancë Magnetike 1.5 deri në 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</i></p>	
	<p><i>Mundësi e heqjes së përkohshme të magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.</i></p>	
	<p><i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.</i></p>	
	<p><i>Mundësi e dhënies së procesorit të zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkorporuar për stimulim elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</i></p>	
	<p><i>Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkorporuar.</i></p>	
	<p><i>Procesori i zërit BTE të ofroje mundësinë që të komunikojë me një mikrofoni tërësisht kontralateral të vendosur në veshin që nuk ka implant</i></p>	
	<p><i>Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale të cilat duhet të ofrohet falas, 1 set. (Në këtë set duhet të përfshihen të gjitha instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale që nevojiten specifikisht për implantin kokë dhe elektrodën që do të implantohet. Seti me të gjitha pajisjet kërkohet të ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues në portofolin e produkteve të tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale që ndihmojnë për një vendosje sa më profesionale dhe cilësore të elektrodës dhe implantit kokë. Në saktësim, nuk kërkohen instrumente të përgjithshme kirurgjike por vetëm instrumente specifike të prodhuesit lidhur me implantin kokë.)</i></p>	

Kontratat do të jepen brenda periudhës: nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE të shpallur fitues, me afat përfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

Afatet e lëvrimit: QSUT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 muaj. Përjashtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër afatet e lëvrimit do të jene si me poshtë:

- 15% e sasisë së kërkuar të objektit të prokuruar duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.*
- pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.*

III.3.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Ofertë Teknike e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k., në të cilën pasqyrohen (Artikulli i kërkuar; Pajisja parësore; Komponentët; Referenca në specifikime; Kompania prodhuese; Origjina; Skadencia; Emërtimi në katalog; Referenca në katalog; Nr. referencës së artikullit; Certifikimi.)
- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
- Katalog “DL – Coil for Sonnet” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Synchrony ST Cochlear Implant Unparalleled MRI Safety” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Rondo Audio Processor” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Sonnet Audio Processor” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Synchrony ST Cochlear Implant” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;

III.3.5. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.3.6. Në nenin 23 pika 1, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : *“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

Gjithashtu në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.[...]”.*

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27 pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 27, pika 6 gërma “b” “Kontratat e Mallrave” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor*

mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike”.

Nga interpretimi telologjik (qëllimi i normës juridike) Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kërkesa për dorëzimin e katalogëve të produktit si një kërkesë e vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit i shërben autoritetit kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me produktin/produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.3.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

III.3.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.3.10. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konkretisht në shtojcën 10 “Specifikime teknike”, ka përcaktuar kriterin “Rezonancë Magnetike 1.5 deri ne 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit”. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin katalogët për pajisjet mjekësore, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këto pajisje.

III.3.11. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, Katalogët e produkteve të ofruara, të përkthyer dhe të noterizuar, dokumentin “Ofertë Teknike” në të cilën pasqyrohen Materialet mjekësore objekt prokurimi si dhe informacionet në lidhje me to për sa i përket Kompanisë prodhuese; Origjinës së mallit; Skadencës së tyre; Emërtimi në Katalog; Numri i referencës (kodi); si dhe Certifikimet.

Konkretisht, operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., për përmbushjen e kriterit “Rezonancë Magnetike 1.5 deri ne 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit”, referuar deklaratës së tij në ofertën teknike, konstatohet se për këtë specifikim ka paraqitur katalogun origjinal dhe të përkthyer “Synchrony ST Cochlear Implant Unparalleled MRI Safety” MED EL, në të cilin, konstatohet se magneti i implantit është 3.0 T MRI, pa qenë nevoja për largimin e

magnetit. Pra, operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur vërteton përmbushjen e specifikimit teknik nr.13, të shtojcës 10, të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Fedos” sh.p.k., nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Fedos” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k. me arsyetimin se [...] *Gjithashtu mungesa e funksionit sipas pikes 17 kufizon pacientet qe te jene ne kontakt ose ne afersi me persona te tjere qe perdorin te njejten paisje duke mos i plotesuar te plote sherbimin qe i eshte ofertuar.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, “Kapaciteti teknik”, pika c dhe f, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“c) Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme per artikullin objekt prokurimi (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te përcaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

f) Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike, per artikujt e kerkuar ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.”

III.4.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, “*Specifikimet teknike*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Nr.	Materiali mjekësor	Specifikimet teknike
1.	Implant Koklear	<p>1. Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm.</p> <p>2. Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.</p> <p>3. Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.</p> <p>4. Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).</p> <p>5. Fuqia e impaktit të shtresës se implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.</p> <p>6. Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kyçit të nofullës ose syzeve).</p>

	7. <i>Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, te jete e rregullueshme ne disa nivele.</i>
	8. <i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).</i>
	9. <i>Sistemi i implantit koklear te jete i pajisur me telekomandë për kontrollin ne distancë të procesorit të zërit.</i>
	10. <i>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</i>
	11. <i>Numri i burimeve te rrymës në implant duhet te jete i barabartë ose me i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.</i>
	12. <i>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion te ndryshimit automatik te programit, pa pasur nevojte te rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).</i>
	13. <i>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi te marrësit/stimulatorit.</i>
	14. <i>Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar(sipas nevojave te sherbimit). Te mundesohen elektroda te drejta ose te paraharkuara.</i>
	15. <i>Rezonancë Magnetike 1.5 deri ne 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</i>
	16. <i>Mundësi e heqjes së përkohshme te magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.</i>
	17. <i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane te ndryshme.</i>
	18. <i>Mundësi e dhënies se procesorit te zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkorporuar për stimulim elektroacustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</i>
	19. <i>Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkorporuar.</i>
	20. <i>Procesori i zërit BTE te ofroje mundësinë qe te komunikojte me nje mikrofonin ëireless kontralateral te vendosur ne veshin qe nuk ka impiant.</i>
	21. <i>Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale i cili duhet të ofrohet falas, 1 set. (Ne ketë set duhet te përfshihen te gjitha instrumentet përshtatëse dhe kirurgjikale qe nevojiten specifikisht për implantin koklear dhe elektrodën qe do te implantohet. Seti me te gjitha pajisjet kërkohet te ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues ka ne portofolin e produkteve te tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale qe ndihmojnë për një vendosje sa me profesionale dhe cilësore te elektrodës dhe implantit koklear. Për saktësim, nuk</i>

	<i>kërkohen instrumente te përgjithshme kirurgjikale, por vetëm instrumente specifike te prodhuesit lidhur me implantin koklear.)</i>
--	---

III.4.3. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimet”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

<i>Nr.</i>	<i>Materiali mjekësor</i>	<i>Specifikimet teknike</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Implant Koklear</i>	<i>Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm.</i>	<i>20</i>
		<i>Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.</i>	
		<i>Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.</i>	
		<i>Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).</i>	
		<i>Fuqia e impaktit të shtresës së implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.</i>	
		<i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kyçit të nofullës ose syzeve).</i>	
		<i>Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, te jete e rregullueshme ne disa nivele.</i>	
		<i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).</i>	
		<i>Sistemi i implantit koklear i pajisur me telekomandë për kontrollin ne distancë të procesorit të zërit.</i>	
		<i>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</i>	
		<i>Numri i burimeve te rrymës në implant duhet te jete i barabartë ose me i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.</i>	
		<i>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion te ndryshimit automatik te programit, pa pasur nevojte te rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).</i>	
		<i>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi te marrësit/stimulatorit.</i>	
		<i>Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar që do ti nënshtrohet implantit(sipas nevojave te sherbimit)</i>	
<i>Te mundesohen elektroda te drejta ose te paraharkuara</i>			
<i>Rezonancë Magnetike 1.5 deri ne 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</i>			

		<i>Mundësi e heqjes së përkohshme të magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.</i>	
		<i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.</i>	
		<i>Mundësi e dhënies së procesorit të zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkorporuar për stimulim elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</i>	
		<i>Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkorporuar.</i>	
		<i>Procesori i zërit BTE të ofroje mundësinë që të komunikojë me një mikrofonin ëireless kontralateral të vendosur në veshin që nuk ka implant</i>	
		<i>Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale i cili duhet të ofrohet falas, 1 set. (Në këtë set duhet të përfshihen të gjitha instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale që nevojiten specifikisht për implantin kokë dhe elektrodën që do të implantohet. Seti me të gjitha pajisjet kërkohet të ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues në portofolin e produkteve të tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale që ndihmojnë për një vendosje sa më profesionale dhe cilësore të elektrodës dhe implantit kokë. Në saktësim, nuk kërkohen instrumente të përgjithshme kirurgjike por vetëm instrumente specifike të prodhuesit lidhur me implantin kokëlear.)</i>	

Kontratat do të jepen brenda periudhës: nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE të shpallur fitues, me afat përfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

Afatet e lëvrimit: QSUT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 muaj. Përbërësit e këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër afatet e lëvrimit do të jepen si më poshtë:

- 15% e sasisë së kërkuar të objektit të prokuruar duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.*
- pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.*

III.4.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Ofertë Teknike e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k., në të cilën pasqyrohen (Artikulli i kërkuar; Pajisja parësore; Komponentët; Referenca në specifikime; Kompania prodhuese; Origjina; Skadencia; Emërtimi në katalog; Referenca në katalog; Nr. referencës së artikullit; Certifikimi.)*

- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
- Katalog “DL – Coil for Sonnet” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Synchrony ST Cochlear Implant Unparalleled MRI Safety” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Rondo Audio Processor” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Sonnet Audio Processor” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;
- Katalog “Synchrony ST Cochlear Implant” MED EL, i përkthyer dhe i noterizuar;

III.4.5. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.4.6. Në nenin 23 pika 1, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : *“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

Gjithashtu në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.[...]”.*

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27 pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 27, pika 6 gërma “b” “Kontratat e Mallrave” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike”.*

Nga interpretimi telologjik (qëllimi i normës juridike) Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kërkesa për dorëzimin e katalogëve të produktit si një kërkesë e vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit i shërben autoritetit kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi

përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me produktin/produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.4.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

III.4.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.4.10. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konkretisht në shtojcën 10 “Specifikime teknike”, ka përcaktuar kriterin *“Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane te ndryshme”*. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin katalogët për pajisjet mjekësore, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përpuethshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këto pajisje.

III.4.11. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, Katalogët e produkteve të ofruara, të përkthyer dhe të noterizuar, dokumentin “Ofertë Teknike” në të cilën pasqyrohen Materialet mjekësore objekt prokurimi si dhe informacionet në lidhje me to për sa i përket Kompanisë prodhuese; Origjinës së mallit; Skadencës së tyre; Emërtimi në Katalog; Numri i referencës (kodi); si dhe Certifikimet.

Konkretisht, operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., për përmbushjen e kriterit *“Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane te ndryshme”*, referuar deklaratës së tij në ofertën teknike, konstatohet se për këtë specifikim ka paraqitur katalogun origjinal dhe të përkthyer “Sonnet Audio Processor” MED EL, pjesa “Sonnet DL-Coil”, në të cilin, konstatohet që DL – Coil për Audio Procesorin Sonnet ka një funksion të integruar të kontrollit të lidhjes së sigurt, e cila monitoron lidhjen e implantit. Pra, operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., përmbush kriterin e vendosur nga autoritetit kontraktor në pikën 17 të specifikimeve teknike, shtojca 10.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Fedos” sh.p.k., nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Fedos” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k. me arsyetimin se [...] - Kemi kerkuar gjithashtu te verifikohet nese OE ka marre deklarate nga prodhuesi qe te mbuloje shpenzimet per plotesimin e pikes, 21 Cdo Implant duhet te jete i shoqeruar me Instrumentet pershtates dhe kirurgjikale i cili duhet te ofrohet falas, 1 set..”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, “Specifikimet teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Nr.	Materiali mjekësor	Specifikimet teknike
1.	Implant Koklear	1. Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm.
		2. Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.
		3. Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.
		4. Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).
		5. Fuqia e impaktit të shtresës së implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.
		6. Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kyçit të nofullës ose syzeve).
		7. Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, te jete e rregullueshme ne disa nivele.
		8. Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).
		9. Sistemi i implantit koklear te jete i pajisur me telekomandë për kontrollin ne distancë të procesorit të zërit.
		10. Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.
		11. Numri i burimeve te rrymës në implant duhet te jete i barabartë ose me i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.
		12. Procesori i zërit duhet të jetë me funksion te ndryshimit automatik te programit, pa pasur nevojte te rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).
		13. Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi te marrësit/stimulatorit.
		14. Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar(sipas nevojave te sherbimit). Te mundesohen elektroda te drejta ose te paraharkuara.
		15. Rezonancë Magnetike 1.5 deri ne 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.

	16. Mundësi e heqjes së përkohshme të magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.
	17. Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.
	18. Mundësi e dhënies së procesorit të zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkorporuar për stimulim elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.
	19. Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkorporuar.
	20. Procesori i zërit BTE të ofroje mundësinë që të komunikojë me një mikrofonin eireless kontralateral të vendosur në veshin që nuk ka implant.
	21. Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale i cili duhet të ofrohet falas, 1 set. (Ne këtë set duhet të përfshihen të gjitha instrumentet përshtatëse dhe kirurgjikale që nevojiten specifikisht për implantin koklear dhe elektrodën që do të implantohet. Seti me të gjitha pajisjet kërkohet të ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues ka në portofolin e produkteve të tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale që ndihmojnë për një vendosje sa më profesionale dhe cilësore të elektrodës dhe implantit koklear. Për saktësim, nuk kërkohen instrumente të përgjithshme kirurgjikale, por vetëm instrumente specifike të prodhuesit lidhur me implantin koklear.)

III.5.2. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimet”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Nr.	Material i mjekësor	Specifikimet teknike	Sasia
1	Implant Koklear	<p>Trashësia e pjesës së brendshme të sistemit të implantit koklear nuk duhet të jetë më shumë se 6 mm.</p> <p>Trashësia e pjesës bazale të elektrodës nuk duhet të jetë më shumë 1.8 mm.</p> <p>Matje direkt e përgjigjes së nervit të dëgjimit ndaj stimulimit elektrik nga implanti dhe ekzaminuesi pa pajisje ose elektroda të jashtme shtesë.</p> <p>Implanti duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) elektroda stimuluese aktive (reale).</p> <p>Fuqia e impaktit të shtresës së implantit (pjesët e implantuara) duhet të jetë minimalisht 2.5 J.</p> <p>Mundësia për të dhënë një procesor zëri OTE që nuk prek veshin (në rastin e problemeve të kyçit të nofullës ose syzeve).</p> <p>Sasia e disponueshme e fuqisë magnetike në BTE, të jete e rregullueshme në disa nivele.</p>	20

	<i>Mundësia për të dhënë një procesor zëri kundra ujit (ëaterproof).</i>	
	<i>Sistemi i implantit koklear i pajisur me telekomandë për kontrollin në distancë të procesorit të zërit.</i>	
	<i>Procesori BTE duhet të ketë minimalisht 2 (dy) mikrofonë.</i>	
	<i>Numri i burimeve të rrymës në implant duhet të jete i barabartë ose me i madh me numrin e kanaleve aktuale reale.</i>	
	<i>Procesori i zërit duhet të jetë me funksion të ndryshimit automatik të programit, pa pasur nevojë të rregullohet me butona ose me aksesoret e jashtëm (jo me rregullim manual).</i>	
	<i>Implanti duhet të jetë me këllëf titaniumi të marrësit/stimulatorit.</i>	
	<i>Operatori ekonomik ofertues, duhet të mundësojë dhënien e një elektrode të drejtë ose të paraharkuar që do të nënshtrohet implantit (sipas nevojave të shërbimit)</i>	
	<i>Te mundësohen elektroda të drejta ose të paraharkuara</i>	
	<i>Rezonancë Magnetike 1.5 deri në 3 T pa pasur nevojë të hiqet magneti nga trupi i implantit.</i>	
	<i>Mundësi e heqjes së përkohshme të magnetit nga marrësi/stimulatori për të bërë Rezonancë Magnetike të kokës me implant.</i>	
	<i>Identifikim elektronik ndërmjet implantit dhe procesorit duke parandaluar shkëmbimin aksidental të procesorit të zërit nga pacientë të ndryshëm ose nga ane të ndryshme.</i>	
	<i>Mundësi e dhënies së procesorit të zërit BTE (mbrapa veshit) me aparat dëgjimi të inkorporuar për stimulim elektroakustik në rast të humbjes së dëgjimit rezidual.</i>	
	<i>Procesor zëri BTE me bobinë për telefon të inkorporuar.</i>	
	<i>Procesori i zërit BTE të ofroje mundësinë që të komunikojë me një mikrofonin ëireless kontralateral të vendosur në veshin që nuk ka implant</i>	
	<i>Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale i cili duhet të ofrohet falas, 1 set. (Në këtë set duhet të përfshihen të gjitha instrumentet përshtatëse dhe kirurgjikale që nevojiten specifikisht për implantin koklear dhe elektrodën do të implantohet. Seti me të gjitha pajisjet kërkohet të ofrohet falas, duke patur parasysh se çdo prodhues ka në portofolin e produkteve të tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale që ndihmojnë për një vendosje sa më profesionale dhe cilësore të elektrodës dhe implantit koklear. Për saktësim, nuk kërkohen instrumente të përgjithshme kirurgjikale, por vetëm instrumente specifike të prodhuesit lidhur me implantin koklear.)</i>	

Kontratat do të jepen brenda periudhës: nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE të shpallur fitues, me afat përfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

Afatet e lëvrimit: QSUT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 muaj. Përjashtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër afatet e lëvrimin do të jene si me poshtë:

- *15% e sasisë se kërkuar te objektit te prokuruar duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit te kontratës.*
- *pjesa e sasisë se mbetur duhet te lëvrohet deri ne përfundim te kontratës dhe sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor.*

III.5.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Deklaratë e operatorit ekonomik “Evita” sh.p.k. për përmbushjen e specifikimeve teknike.
- Autorizim prodhuesi lëshuar nga kompania MED EL, për operatorin ekonomik “Evita” sh.p.k., për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. (përkthyer dhe noterizuar)
- Deklaratë për asistencë teknike të lëshuar nga prodhuesi MED EL, për operatorin ekonomik “Evita” sh.p.k. (përkthyer dhe noterizuar)
- Dokumentin “Declaration Surgical Tools Med-El”, të përkthyer dhe të notërizuar, bë të cilën deklarohet se prodhuesi MED-EL, deklaron sigurimin falas të set-eve kirurgjikale të nevojshme për kirurgjinë e implantit koklear dhe matësit intraoperative të listuar [...]
- Deklaratë Garancie për produktet nga prodhuesi MED EL (përkthyer dhe noterizuar)

III.5.4. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.5.5. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

III.5.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.5.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konkretisht në shtojcën 10 “Specifikime teknike”, pika 21 ka përcaktuar kriterin *“Çdo Implant duhet të jetë i shoqëruar me Instrumentet përshtatës dhe kirurgjikale i cili duhet të ofrohet falas, 1 set. (Ne këtë set duhet te përfshihen te gjitha instrumentet përshtatëse dhe kirurgjikale qe nevojiten specifikisht për implantin koklear dhe elektrodën qe do te implantohet. Seti me te gjitha pajisjet kërkohet te ofrohet falas, duke patur*

parasysh se çdo prodhues ka ne portofolin e produkteve te tij edhe setin e instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikale qe ndihmojnë për një vendosje sa me profesionale dhe cilësore te elektrodës dhe implantit koklear. Për saktësim, nuk kërkohen instrumente te përgjithshme kirurgjikale, por vetëm instrumente specifike te prodhuesit lidhur me implantin koklear.)”.

III.5.8. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k., konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm, ka paraqitur Deklaratën e lëshuar nga prodhuesi MED-EL, i cili prodhon implantet e ofertuara nga operatori ekonomik “Evita” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, në të cilën deklarohet se *“MED-EL Elektromedizinische Cerate GmbH, si prodhues i implanteve të dëgjimit, deklaron sigurimin falas të set-eve kirurgjikale të nevojshme për kirurgjinë e implantit koklear dhe matësit intraoperative të listuara [...]”.*

Gjithashtu, operatori ekonomik “Evita” sh.p.k. në deklaratën e tij për përmbushjen e specifikimeve teknike, deklaron se *“Mbështetur në deklaratën e kompanisë prodhuese të Implantit Koklear MED-EL datë 29.08.2019, do të garantojmë ofrimin falas 1 set të instrumenteve përshtatës dhe kirurgjikal. (Në këtë set do të përfshihen të gjitha instrumentet përshtatës dhe kirurgjikalë që nevojiten specifikisht për implantin koklear dhe elektrodën që do të implantohet).*

Pra, sa më sipër operatori ekonomik “Evita” sh.p.k. ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, qëllimi i të cilit është sigurimi falas i seteve kirurgjikal dhe instrumentave të përshtatshëm, të cilët duhet të shoqërojnë implantin.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Fedos” sh.p.k., nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa mësipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k, mbi ofertën e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me nr. REF-33686-08-16-2019, me objekt: *“Blerje materiale mjekësore specifike për Shërbimin e ORL në QSUT/Implanti Koklear”*, me fond limit, vlera e pritshme e kontratave 61.925.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1685 Protokoli

Datë 30.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha